



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

**KUVENDI**

***Komisioni për Ekonominë dhe Financat***

**PROCESVERBAL**

Tiranë, më 22.05.2018, ora 10:00

**Drejton mbledhjen:**

**Erion Braçe – kryetar i Komisionit**

**Rendi i ditës:**

1. Miratimi i procesverbalit.
2. Raporti vjetor i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare për vitin 2017 – kthimi i përgjigjeve të pyetjeve dhe diskutime.

**Marrin pjesë:**

Erion Braçe, Jorida Tabaku, Evis Kushi, Roland Xhelilaj, Arben Pëllumbi, Antoneta Dhima, Xhevit Bushaj, Edmond Spaho, Fatbardha Kadiu, Agron Shehaj, Përparim Spahiu, Pjerin Ndreu, Dhurata Çupi dhe deputetë të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike.

**Mungojnë:**

Anastas Angjeli, Blerina Gjylameti, Ervin Bushati, Ilir Xhakolli, Dashamir Shehi, Reme Lala, Nadire Meçorapaj dhe Edmond Haxhinasto.

**Të ftuar:**

Ervin Koçi – Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare  
Pajtim Melani – Kryetar i Bordit Drejtues të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare  
Lyela Rama – Drejtoreshë e Departamentit të Mbikëqyrjes së Tregut të Sigurimeve të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare  
Violanda Theodhori – Drejtoreshë e Departamenti Juridik të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare  
Niko Kotonika – Drejtor i Departamentit të Mbikëqyrjes së Tregut të Kapitaleve dhe Fondeve të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare

## HAPET MBLEDHJA

**Erion Braçe** – Mirëmëngjesi të gjithëve! Fillojmë mbledhjen e Komisionit për Ekonominë dhe Financat. Siç jeni lajmëruar edhe më herët gjatë javës që shkoi, sot kemi vijimin e seancave, që kanë të bëjnë me raportin vjetor të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare për vitin 2017. Seanca do të vijojë me përgjigjet e pyetjeve që deputetët e këtij komisioni i kanë adresuar bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare dhe krahut të tij ekzekutiv. Pyetjet janë të njohura. Jemi te pyetja numër 10, kështu që duhet të vijojmë me përgjigjet e pyetje të tjera, nga pyetja 11 e tutje.

Urdhëroni!

**Jorida Tabaku** – Zoti Braçe, në fakt, ne u larguam dje nga komisioni dhe nuk ishim në pjesën e dytë të diskutimeve që u zhvilluan këtu, por u njohëm nga media me faktin që dy gazetarëve të terrenit, të cilat kanë qenë prezente në komision gjatë ditëve të fundit, ju u kërkuat të largohen. Unë nuk e di se çfarë ka ndodhur, sepse as unë, por as kolegët e mi nuk kemi qenë prezentë, por nuk më duket se është një akt shumë i bukur, për më tepër për gazetarët e terrenit, të cilët punojnë pa u lodhur për të mbuluar veprimtarinë e komisionit tonë, por edhe të parlamentit. Ju, duke qenë gazetar, besoj se i kuptoni më mirë vështirësitë e tyre, për më tepër që ishin të dyja zonja. Nuk është në standardin e këtij komisionin, të paktën për sa kohë që unë kam qenë në këtë komision (këtu kemi pasur transparencë) dhe nuk është në standardin e asnjërit prej nesh që jemi këtu që gazetarët, të cilët ndjekin punimet e komisionit, të largohen nga komisioni. Kjo sallë parlamenti, por edhe sallat e tjera kanë parë kriminelë që kanë hyrë dhe kanë dalë, por që nuk i ka nxjerrë njeri nga komisioni. Të nxjerrim dy gazetarë, të cilat ndoshta kanë qenë duke diskutuar! Mesa bisedova unë me to më pas, ato ishin prekur dhe ishin mërzhitur shumë. Të dyja ishin profesioniste dhe asnjëra prej tyre nuk e mbulon PD-në. Mua nuk më duket normale kjo gjë. Transparencën e munguar të qeverisë ky komision e ka ofruar deri tani dhe shpresoj të vazhdojë ta ofrojë. Nuk më duket një akt normal. Besoj se kam edhe mirëkuptimin tuaj për faktin se, duke qenë se shumica janë zonja, zonjat, që mbulojnë Komisionin e Ekonomisë, kanë një sjellje profesionale, janë treguar korrekte, nuk kemi pasur asnjëherë problematika në komision dhe jam e sigurt se kështu do të vazhdojë. Të paktën për kolegët e opozitës, mungesa e transparencës është një akt i paprecedent. Unë e kuptoj që ne ndonjëherë nxe kemi dhe i themi

shumë fjalë njëri-tjetrit, madje edhe e fyejmë, por të paktën të mos lejojmë që kjo të mos kalojë përtej nesh, të mos kalojë te palët e treta.

Faleminderit!

**Erion Braçe** – Zonja Tabaku, unë prisja që ju të mos kopjonit kryetarin e partisë, por thjesht të dinit se çfarë ka ndodhur. Në kushtet kur ju nuk dini se çfarë ka ndodhur, nuk ju mirëkuptoj...

**Jorida Tabaku** – Pashë vetëm reagimin tuaj.

**Erion Braçe** – Pikërisht. Ky është problemi juaj. Unë nuk e teproj asnjëherë kur zbatoj Rregulloren. Rregullorja e masmedias, e firmosur nga Ish-Kryetari i Kuvendit dhe jo nga unë, në nenin 32 thotë: “Personat e akredituar pranë Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, që ndjekin punimet në seancë plenare dhe në organet e Kuvendit, nuk duhet të shprehin shenja, miratime apo mosmiratime dhe janë të detyruar të respektojnë rregullat e përcaktuara nga Byroja e Kuvendit për mbajtjen e qetësisë. Në rast shkeljeje të tyre, drejtuesi i mbledhjes kërkon largimin e tyre nga salla.”

Zonjat nuk kanë bërë këtë, por shumë më tepër se kaq. Këto janë rregullat.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Te kjo çështje?

**Florjon Mima** – Te kjo çështja jonë e përbashkët, e rëndë. E dëgjova citimin që i bërë rregullores, por unë gjykoj se sot medieve u detyrohesh një falje...

**Erion Braçe** – Patjetër, mund t’ua bësh!

**Florjon Mima** – Nuk e bën ti?! E bëj unë në emrin tënd. Nuk ka problem.

**Erion Braçe** – Bëje ti, pa asnjë lloj problemi!

**Florjon Mima** – Ne këtu na ka sjellë populli. Edhe kur zihemi, edhe kur pajtohemi, populli do të dijë se çfarë themi ne me njëri-tjetrin dhe janë ato vajzat, të cilat ti i nxore jashtë dje, që e bëjnë këtë punë me besnikëri, me integritet dhe pa mbajtur krahun e askujt. Po të mos ishin ato, ne nuk do të kishim mësuar për 5 milionët që Habilajt ia taksnin çdo muaj ministrit të parë të Brendshëm. Po të mos ishin ato, ne nuk do të kishim ditur asgjë për 20 milionë eurot, të cilat i duheshin ministrit, si kreu i një qarku... Po të mos ishin ato, zotëri...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Më dëgjoj ta mbaroj unë, se dy sekonda do të flas! Po të mos ishin ato, ne nuk do të dinim që Nazer Seiti u arratis brenda natës, me bashkëpunimin e qeverisë, vetëm që të mos ishte

këtu. Po të mos ishin ato, ne nuk do t'i dëgjonim këto hyjneret që po dalin përditë. Kështu është e vërteta. Ne nga mediet i kemi mësuar të gjitha, edhe që vëllai i ministrit aktual është i dënuar...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Ne të gjithë u detyrohemi medieeve, edhe kur jemi në pushtet, edhe kur jemi në opozitë, na pëlqen apo nuk na pëlqen ajo që shkruajnë ato. Edhe ato kanë dinjitetin e tyre. Vijnë këtu dhe e nxjerrin bukën me dinjitet dhe integritet. U detyrohemi shumë atyre. Ndaj, i thashë zotit Braçe se duhet të kërkojë falje. Po nuk e bëre ti, e bëj unë në emër të opozitës.

**Erion Braçe** – Zoti Mima, unë nuk e kuptoj pse nxeheni njëherë!

*(Reagime pa mikrofon)*

Edhe një herë, zoti Mima, unë jam i detyruar të dëgjoj edhe hyjnerë. Nuk është ndonjë problem i madh. Në këtë histori gjithsecili ka të drejtën të thotë atë që mendon dhe ta thotë si të dojë. Ndjesë, edhe që vëzhgova se toni juaj nuk ishte në normalitet. Mua më intereson e vërteta. Të gjitha ato që thatë ju, nuk janë zbuluar nga gazetarët, sidomos ato të habilajve, nazërajve apo ku di unë si i kanë emrat ata.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Nuk e di nga i keni mësuar ju. Unë i kam mësuar nga një raport i policisë italiane, ose më saktë i Policisë Financiare Italiane.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Po, pra, edhe këtë rastin e fundit, për të cilin po flisni ju, unë e kam dëgjuar nga Partia Demokratike dhe jo nga gazetarët. Gazetari doli dhe tha: “Unë nuk di asgjë”. Çfarë rëndësie ka kjo?! Kjo është një histori tjetër; është e prokurorisë. Kështu që...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Patjetër, unë mezi prita dhe në darkë të shikoja videon dhe mezi kam ndenjur të shikoja videon dhe e pashë videon...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Pa merak... Ju thashë edhe një herë, ka një rregullore Kuvendi i Republikës së Shqipërisë për të gjithë ata që akreditohen dhe që mundohen të bëjnë punën e tyre në ambientet e Kuvendit. Në momentin kur shkelet kjo rregullore...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Kanë bërë shumë më tepër se kaq dhe ti nuk ke qenë fare këtu.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Mund të lexosh intervistën e çdokujt. Nuk me intereson fare. Ky është problemi: kur nuk je këtu, lexon diçka dhe mendon se ke dëgjuar të vërtetën. Në rast se ju duhet, mund të ndiqni pamjet e këtyre kamerave këtu dhe besoj se do të kuptoni se çfarë ka ndodhur. Ç'rëndësi ka...

Urdhëroni, zotëri, keni fjalën!

**Agron Shehaj** – Faleminderit!

Për shkak të përgjimeve këto ditë është folur shumë për Vlorën; është folur për ministra trafikantë, për drejtues policie trafikantë, për të afërm të ministrave trafikantë. Skema është sa e thjeshtë, aq edhe e pabesueshme. Edhe unë do ta kisha të vështirë ta besoja nëse këto nuk do të ishin provuar nga prokuroria dhe gjykata italiane. Nga një anë kemi ministra trafikantë, një nga të cilët është në arrest për trafik drogë, në anën tjetër kemi të afërm të tyre në burg në Itali, në hetim ose në burg, se janë dënuar për trafik droge, dhe po në anën tjetër kemi shefa policie në kërkim, të cilët janë akuzuar po për trafik droge.

Për të gjitha këto ne vazhdojmë e flasim dhe bëjmë mirë që flasim. Kemi folur shumë për Vlorën, por nuk kemi folur për pjesën kryesore të qytetit të Vlorës, nuk kemi folur për qytetarët vlonjatë, që kanë vuajtur, që do të vuajnë dhe që po i vuajnë edhe sot pasojat e kësaj skeme kriminale, e cila ka për të mbetur në historinë e Shqipërisë dhe që e ka njollosur Shqipërinë në rajon e në të gjithë botën; për vlonjatët, ata që nuk kanë ikur ende; ata që duan të jetojnë një jetë të qetë, ata që duan një punë normale dhe që ëndërrojnë një jetë më të mirë për fëmijët e tyre. Nuk kemi folur për nënat që jetojnë me terrorin se mos fëmijët e tyre bëhen pre e parasë së lehtë e të shpejtë dhe bëhen skafistë, sepse Tahiri, vëllai i Xhafajt apo shefat e policisë nuk e ngisnin vetë skafin me drogë, duke rrezikuar jetën, por dërgonin të rinjtë vlonjatë që të mbyteshin në det, ose njerëz si Babalja, me të cilët pastaj tallen dhe në rastin më të mirë i lënë të kalben burgjeve.

A e dini se sa persona kanë mbetur të lënduar në atentat për vrasje në qytetin e Vlorës vetëm në vitin 2017? 17 veta, nga të cilët 6 të vrarë dhe 11 të plagosur, midis tyre edhe një 8-vjeçar.

A keni dëgjuar ndonjëherë për misterin e peshkatarëve vlonjatë të humbur në det? Sipas një reportazhi të vyer të Zërit të Amerikës, mes viteve 2016-2017, kanë qenë të paktën 13 persona, që kanë humbur jetën në det dhe dyshohen se kanë qenë të përfshirë në trafik droge, por që policia i regjistron si peshkatarë të humbur. Ky është misteri i peshkatarëve të humbur në qytetin e Vlorës.

Fevzilete Senkaj, është nëna e moshuar e një djali të ri, Leonard Senkaj, që, sipas policisë, është një prej peshkatarëve të zhdukur në det, por që ajo vazhdon dhe e thërret. Shkoni dhe thojni asaj se ministri Xhafaj nuk ka lidhje me të vëllanë, që është i dënuar në Itali dhe i përfshirë në Shqipëri në trafikun e drogës. Shkoni thojni asaj!

Shkoni thojni nënës së 8-vjeçarit të plagosur në atentat, që Tahiri ishte i pafajshëm dhe se audio-përgjimi i antimafias italiane nuk është provë.

Thojuni tre fëmijëve të mitur të Adrian Hitajt, i cili doli në det dhe nuk u kthye më, që ministrat, të afërmit e tyre dhe shefat e policisë e kthyen Vlorën në bazën kryesore të trafikimit, por nuk e dinte dhe nuk mban përgjegjësi, sepse nuk dinte as për ministra, as për të afërmit e ministrave dhe as për shefat e policisë.

Secili prej anëtarëve të kësaj maxhorance, deputet apo ministër që mbron me verbëri këta pushtetarë trafikantë janë përgjegjësit e vërtetë të këtyre vrasjeve dhe vdekjeve. Në vend që të vini këtu dhe t'i mbron, duhet të shkoni t'u gjunjëzoheni dhe t'u kërkonit falje atyre familjeve që kanë humbur të afërmit, pasi, po të mos e kishit lejuar trafikun e drogës në Vlorë, ata do të ishin sot gjallë. Jam i bindur që nuk ju vret fare ndërgjegjja, sepse po të ishte ndryshe, ndonjëri prej jush do ta kishte ngritur zërin, por ju heshtët dhe kjo ju bën përgjegjës. Ju vjen për të qeshur, por ju bën përgjegjës, sepse ju e mbajtët dhe ju e votuat. Ju jeni përgjegjës, sepse me heshtjen dhe votat tuaja ndërtuat këtë shtet kriminal.

Vetëm në Shqipëri ndodh që kur një gazetar i guximshëm nxjerr një provë me audio, video dhe dëshmitar, qeveria dhe prokuroria përndjekin dhe hetojnë gazetarin dhe jo trafikantët. Vetëm këtu ndodh. Duheshin pothuajse 4 vjet që të zbuloheshin provat e mjaftueshme për të arrestuar ish-ministrin e Brendshëm të parë të qeverisë “Rama”. Përfshirja e ministrit të dytë të Brendshëm u zbulua në më pak se 1 vit. Shqiptarët nuk e kuptojnë se si është e mundur që ministri i Brendshëm Xhafaj, nuk e ka dhënë akoma dorëheqjen. Si do të mundet ministri të takojë homologët e vet, për shembull atë italian, ndërkohë që vëllai i tij është në burg për trafik droge? Për çfarë do të flasin? Rama duhet t'i jap fund këtij turpi dhe ta shkarkojë sa më shpejt ministrin e Brendshëm.

Faleminderit!

**Aldo Bumçi** – Faleminderit, zoti Braçe!

Duke parë humbjet e mëdha që po ndodhin në ekonominë shqiptare, parlamenti duhet t'i kishte dedikuar, jo një seancë, por një sërë seancash këtij shqetësimi, i cili është bërë publik nga shoqatat e prodhuesve shqiptarë dhe eksportuesve.

Në 4 muajt e parë të këtij viti janë regjistruar...

**Erion Braçe** – Të ndërpritet mbledhja!

Zotëri, dil përjashta!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Aldo Bumçi** - A mund ta dimë për çfarë arsye, sepse ky është parlament...

*(Mbledhja ndërpritet dhe rifillon pas rreth gjysmë ore. Deputetët e opozitës janë larguar nga salla.)*

**Erion Braçe** – Mirëmëngjesi edhe një herë!

Po rifillojmë mbledhjen e Komisionit të Ekonomisë dhe Financave, pasi rrugaçi që ka edhe para shumë në këtë vend nuk është më në sallën e punës së komisionit.

Jemi në seancën e pyetjeve dhe përgjigjeve të mara, do të vijomë me pyetjen e njëmbëdhjetë.

Urdhëroni!

**Evis Kushi** – Faleminderit, kryetar!

Së pari, falënderoj kryetarin e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare jo vetëm për punën dhe raportin e prezantuar, por edhe për gatishmërinë për t'iu përgjigjur pyetjeve të shumta që ne si komision i kemi bërë. Duke u nisur edhe nga seanca e kaluar, ku u diskutuan shumë pyetje, konstatoj se pjesa më e madhe e pyetjeve që i kisha drejtuar kryetarit janë ezauruar, prandaj jam e qartë në lidhje me pyetjet që kam bërë, prandaj i tërheq.

Faleminderit!

**Erion Braçe** – Vazhdojmë me pyetjen e 11-të.

**Ervin Koçi** – Faleminderit kryetar!

Pyetja e radhës është: a jeni në gjendje të na thoni sa është vlera reale e dëmeve të prapambetura, objekti i fondit të kompensimit dhe sipas vlerësimeve tuaja sa pritet të ndryshojë në vijim? Shifrat që raportohen tani a janë të certifikuara?

Vlera e dëmeve të prapambetura objekt i Fondit të Kompensimit, që i përafrohet realitetit, erdhi pas inspektimeve dhe janë vlerat që janë të përcaktuara në vendimin e bordit të dhjetorit të vitit të kaluar, vendim, i cili siguron përfundimin e pagesave gjatë vitit 2018 të të gjitha

detyrimeve të prapambetura të Fondit të Kompensimit, si dhe provigjionimin e çdo vlere që është në proces trajtimi apo objekt gjykimi nga gjykata. Gjithsej, dëmet e Fondit të Kompensimit, ku përfshihen të papaguarat, ato që janë në proces trajtimi nga byroja dhe shoqëritë, dosjet objekt gjykimi në Shkallë të Parë dhe në Apel, janë në vlerën 1 668 557 854 lekëve, nga të cilat rreth 50% prej tyre janë detyrime të papaguara dhe pjesa është për t'u provigjionuar. Faktikisht vlerat ndryshojmë për shkak të shumë faktorëve, ku një prej faktorëve kryesorë janë vendimet e gjykatave. Sot që jemi duke folur rreth 45% e dosjeve janë në gjykim nëpër gjykata.

Arsyeja e dytë është se 5% e dosjeve janë në proces trajtimi nga shoqëritë dhe normalisht mund të ketë ndryshim vlere ose në qoftë se qytetari nuk bie dakord, atëherë ai mund ta padisë në gjykatë dhe kështu mund të ketë vlerësim tjetër nga gjykata, interesat mbi vonesat, si dhe shpenzimet e tjera që lidhen me ekzekutimin e tyre nga Zyra Përmbartimore.

Vendimi i Bordit parashikon që e gjithë kjo vlerë për dëmet e papaguara të mbyllet për vitin 2018, pra çdo qytetar të ketë marrë vetë çfarë i takon dhe që i ka munguar për vite me radhë dhe pjesa tjetër do të jetë e provigjionuar sipas ligjeve në fuqi. Shifrat nuk janë të certifikuara, gjë që ishte edhe objekt i pyetjeve tuaja në mbledhjen e zhvilluar një javë më parë, pasi ende nuk ka filluar auditimi nga shoqëritë audituese ndërkombëtare.

Nga informacioni më i fundit që kemi marrë është proceduar nga byroja për zgjedhjen e shoqërisë dhe tashmë po negocion për kushtet e kontratës. Gjithsesi, ne po shohim të gjitha hapësirat ligjore, edhe pse ka disa mangësi për ta përzgjedhur edhe ne vetë nga autoriteti audituesin, në qoftë se ata nuk operojnë brenda këtij muaji. Gjithashtu, si autoritet kemi filluar të verifikojmë të gjitha dosjet që janë objekt fond kompensimi të paguara dhe të papaguara nga viti 2008, me vlerë mbi 1 milion lekë, duke bashkëpunuar edhe me Policinë e Shtetit.

**Erion Braçe** – Drejtor, unë ju dëgjova edhe në seancën që shkoi, por edhe tani po ju dëgjoj për këtë çështje dhe mendoj se është një nga çështjet më të rëndësishme që ne kemi ngritur si komision edhe gjatë vitit 2017 në raport me vitet e shkuara, por besoj se do të jetë edhe një nga çështjet themelore të këtij viti. Ajo që më shqetëson është se duke iu referuar vendimit që ju keni marrë në maj të këtij viti, edhe pjesës konstatuese, edhe pikave 2 dhe 3 më rezulton që asambleja respektive e Bordit të Kompensimit apo çfarë quhet ai, nuk i zbaton vendimet që ju merrni.

Po t'i referohem vendimit që keni marrë në dhjetor të vitit 2017, krahasuar me vendimin që ju keni marrë në maj, rezulton ekzaktësisht kjo. Unë nuk e di dhe nuk jam në gjendje t'ju



them tani se cili është instrumenti, por besoj se në raportin përfundimtar vlerësimi i punës i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare nga ky komision mund të ketë një instrument. Po ju a keni menduar ndonjë instrument tjetër me qëllim që të detyrohet asambleja e këtyre që të zbatojë vendimin apo vendimet që merr bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare?

Fjala bie, në atë vendim unë gjej të bëj shlyerjen e menjëhershme të një pjese të dëmeve të prapambetura në masën 923 354 758 lekë, pika 2 e vendimit. A e zbatojnë ata këtë? Nga i gjithë raportimi që ju keni thënë më rezulton se nuk e kanë zbatuar. Çfarë duhet të bëjmë ne me këta?

Urdhëroni!

**Ervin Koçi** – Po, kryetar, shqetësimi juaj është i drejtë në të dyja çështjet që ngrini. Faktikisht ka qenë objekt diskutimi edhe për ne si Autoritet për shkak se ju thamë se ka disa mangësi ligjore, por, në qoftë se ne si bord marrim një vendim për të shkarkuar asamblenë, e cila shkarkon të gjithë drejtorët e Përgjithshëm i bie që tregu të hyj në kolaps dhe neve si shtet Byroja Europiane na heq kartonin jeshil. Pra, ky është një problem për të cilin jemi munduar dhe e kemi parë që ne të kemi të drejtën si Autoritet. Faktikisht po të shohësh parimin e diskrecionit ku ne marrim disa kompetenca ka qenë objekt diskutimi, por gjithsesi ne nuk mund të marrim një vendim që të jetë në kundërshtim me ligjin, pasi menjëherë do të paditet nga ata në gjykatë.

Mendoj se ky shqetësim, i cili na merr edhe pjesën më të madhe të kohës së punës, është i drejtë, por do t'ju kërkoja minimalisht që të paktën të procedonim ligjin e ri, sepse do të vazhdohet me këtë histori në qoftë se ata nuk kanë një mbikëqyrje të plotë dhe ligjore nga autoriteti.

Gjithsesi, jemi duke e parë dhe kemi bërë një propozim për mbledhjen e ardhshme të bordit, për t'i marrë ne qoftë shoqërinë audituese, të emërojmë drejtorin e bordit dhe njëkohësisht, qoftë shpërndarjen e dosjeve si autoritet. Pra, jemi duke e parë, por po shohim hapësirat ligjore, kjo është gjithçka që kemi diskutuar.

**Erion Braçe** – Drejtor, a e dini se cili është shqetësimi im? Këtë që ju sapo thatë e vendos Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare në kushte shantazhi prej kompanive në raport me autoritetin europian që ju thoni, i cili mund të na heqë kartonin jeshil. Ndërkohë, mua më rezulton që Byroja Shqiptare e Sigurimeve është në kushte paligjshmërie totale. Siç edhe ju thoni në vendimin e fundit, që prej janarit të 2016 drejtori Ekzekutiv është i pamiratuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare. Nuk është miratuar në atë kohë dhe vazhdon të jetë i pamiratuar edhe

tani, vetëm në qoftë se ju keni marrë ndonjë vendim së fundmi, pra vazhdon të jetë i pamiratuar dhe ka një arsye, sepse ky drejtor nuk përmbush kushtet ligjore që janë përcaktuar në ligj për të qenë titullar i Byrosë Shqiptare të Sigurimeve.

Tani më thoni, do të vazhdojmë ne që për shkak të shantazhit të pranojmë paligjshmërinë në Byronë Shqiptare të Sigurimeve, duke filluar që nga drejtori Ekzekutiv i saj deri te moszbatimi i vendimeve prej këtij institucioni? Kjo histori nuk mund të vazhdojë të jetë kështu, ata nuk mund të imponojmë paligjshmëri, nuk mund të thonë se këtë duam ne dhe ju duhet ta pranoni, pavarësisht se ky person bie në kundërshtim me të gjitha përcaktimet që ka bërë ligji që është në fuqi.

**Ervin Koçi** – Kemi bërë disa shkresa për drejtorin e Byrosë dhe disa propozime, por nuk ka vepruar dhe së fundmi para 4 ditësh kam propozuar një person për drejtor byroje dhe besoj se qëndrimi ynë dhe i palës ekzekutive rezidente në bord...

**Erion Braçe** – Nuk ju dëgjova, çfarë kanë bërë?

**Ervin Koçi** – Kam bërë një propozim për drejtor byroje, por në qëndrimin tonë si ekzekutiv, gjë të cilën do ta diskutojmë edhe në mbledhjen e radhës së bordit është se nuk jemi dakord që ai person të jetë drejtor, sepse nuk i plotëson kriteret.

**Erion Braçe** – Patjetër.

**Ervin Koçi** – Kryetar, unë e kuptoj shqetësimin tuaj, i cili është mjaft i drejtë për publikun, si dhe për rreth 500 qytetarë, të cilën ende nuk i kanë marrë paratë e tyre. Ata kanë shfrytëzuar në maksimum gabimin ligjor që është bërë në vitin 2009, kur është miratuar ligji, ku Autoritetit i janë hequr disa të drejta. Gjithsesi, mendoj se këtë gjë mund ta diskutojmë edhe me juristët tuaj dhe të shohim mundësitë që ne kemi dhe jam i gatshëm që sot për çfarë të thoni ju, por vetëm se duhet të jemi brenda ligjit dhe të veprojmë, sepse momenti është...

**Erion Braçe** – Pa asnjë lloj diskutimi ne jemi të hapur në këtë aspekt, por ama ne nuk mund ta pranojmë gjendjen e paligjshmërisë që është në Byronë Shqiptare të Sigurimeve.

Mendoj se nuk ju duhen ndryshimet ligjore për të vendosur në shinat e ligjshmërisë bordin dhe Byronë Shqiptare të Sigurimeve...

**Ervin Koçi** – Përveç kësaj...

**Erion Braçe** - ...duhet vendimmarrja juaj, për ta çliruar edhe Autoritetin nga shantazhi i këtyre, si dhe për të rikthyer ligjshmërinë në një institucion që ka marrëdhënie të drejtpërdrejta me qytetarët e Republikës së Shqipërisë.

**Ervin Koçi** – Duke u nisur nga ky shqetësim, ne si Autoritet, jua thashë edhe më pak më parë, kur iu përgjigjja pyetjes, të gjitha dosjet që janë nga viti 2008 po i hetojmë për të parë vërtetësinë e tyre duke bashkëpunuar edhe me Policinë e Shtetit, pasi edhe ne kemi dyshimet tona, gjë të cilën ju e thatë edhe në mbledhjen e kaluar, sepse vlerat shpeshherë ndryshojnë, janë të paqarta, shumë dinamike, të cilat të bëjnë ndonjëherë të mos marrësh vendimet e duhura dhe besoj se nga hetimet e para ka disa çështje, por shpresoj të mos jemi nxituar. Jam shumë i vendosur jo vetëm për të ndryshuar këtej e tutje situatën, por edhe çfarë është bërë nga e kaluara, sepse duhet të mbyllim njëherë mirë këtë histori, e cila që nga viti 2002 mban peng zhvillimin e sektorit të sigurimeve.

Po deklarohet në Kuvend se nuk është raportuar saktë për detyrimet e fondit të kompensimit. A e keni analizuar këtë situatë, pra të raportimeve të pasakta të shtrembëruara në bordin e autoritetit? Komisioni kërkon të dijë cilët janë përgjegjësit dhe masat që janë marrë.

Kujtojmë se çështja e shlyerjes së detyrimeve të prapambetura të fondit të kompensimit është madhore jo vetëm për qytetarët që do të marrin këtë dëmshpërblim, por ka qenë një ndër kushtet e negocimit me një institucion financiar si Banka Botërore.

Evidentimi i saktë është ndër shqetësimet kryesore të miat që në fillim të marrjes së detyrës, i cili na krijonte mundësinë për të marrë një vendim të drejtë dhe i saktë. Për këtë kemi kryer 4 inspektime pranë byrove të shoqërive për të saktësuar shifrat e raportuara, ndërkohë që për periudhën e mëparshme nuk kishim asnjë hetim. Të dhënat për fondin e kompensimit analizohen çdo tremujor në bord. Duke marrë në analizë këto raportime dhe inspektimet e kryera, dolën në konkluzionin që këto të dhëna nuk janë raportuar saktë në periudhat e mëparshme. Kjo ka ardhur si rezultat e një sërë arsyes, ku ndër më kryesoret është raportimi i cunguar dhe jo i saktë i ardhur nga byroja duke filluar nga viti 2002. Byroja nuk ka një sistem informatik të mbajtjes së dosjeve. Pas kërkesave tona të vazhdueshme, tashmë janë duke vendosur këtë sistem për dosjet dhe pagesat e dëmeve. Njëkohësisht nuk është kryer auditimi i jashtëm për aktivitetin e byrosë, sidomos inspektimi nga autoriteti që kishte sjellë me mungesa informacionin. Ne kemi evidentuar këto mangësi dhe mendojmë se përgjegjësitë në lidhje me mosraportimin e saktë kanë të bëjnë me keqfunksionimin e byrosë në vite që nga strukturat drejtuese deri tek asambleja e përgjithshme e byrosë. Asambleja përbëhet nga drejtorët e përgjithshëm të shoqërive, nga viti 2009 kur byrja ndryshoi funksionimin me ligj. Kjo ka sjellë edhe rritjen e problematikave. Njëkohësisht kemi konstatuar se një problem është mosndjekja e

monitorimit korrekt dhe periodik të veprimtarisë së byrosë nga ana e autoritetit. Ky është një problem i trashëguar në vite dhe nuk mund të sheshohej që në muajt e parë të veprimtarisë sime në këtë institucion. Në momentin që kam filluar detyrën, aktiviteti i byrosë nuk kontrollohej nga departamenti përkatës, madje nuk e njihte as si përgjegjësi. Në strukturën e re ne kemi caktuar një punonjës të mbikëqyrjes së byrosë. Ndryshimi i drejtuesve të byrosë në vite ka sjellë edhe probleme me Byronë Europiane të Sigurimeve, nga e cila jemi në monitorim.

Shlyerja e pagesave të dëmeve dhe kompensimit mbetet një shqetësim yni, i Komisionit të Ekonomisë, i Bankës Botërore, është sektori me prioritet të veçantë nga Autoriteti për vitin 2017.

Gjatë vitit 2017 veç inspektimeve pranë byrosë që bëhen nga autoriteti, kemi shpërndarë dosjet duke filluar nga detyrimet më të hershme, nga viti 2002.

Një masë tjetër e marrë nga autoriteti është saktësimi i praktikave të miratuara të papaguara, të cilat vazhdonin të paraqiteshin si detyrim me justifikimin se palët nuk paraqiteshin. Për këtë autoriteti kërkoi publikimin e emrave të përfituesve, që lidhen me praktikat administrative të miratuara dhe të papaguara, të cilat nuk paraqiteshin në byro. Byroja ka bërë shpalljen publike të 206 emrave në faqen zyrtare, të cilën e kemi bërë edhe ne si autoritet dhe aktualisht është në fazën e këtij procesi. Me vendimin e muajit dhjetor paguhën dëmet për detyrimet e këtij fondi, të cilat lidhen me praktikat në proces dhe është kërkuar nga shoqëritë e sigurimit që t'u bëhet një propogjenim i saktë i tyre, sepse shpeshherë propogjenimi i tyre nuk bëhet në mënyrë të saktë, duke pasuruar vlerën respektive të këtij propogjenimi në pasqyrat financiare periodike ose vendimet e gjykatave, që nuk janë të formës së prerë. Njëkohësisht ne kërkojmë informacion çdo muaj për ndryshimin e detyrimeve sipas statusit të praktikës, duke ndryshuar inspektimet për ta ndjekur në vend procesin e pagesave të dëmeve. Për mosndjekje me përgjegjësinë e duhur të fondit të kompensimit nga autoriteti për problematika të tjera të mbartura në tregun e sigurimeve, drejtuesi i departamentit të mbikëqyrjes është larguar nga Autoriteti.

**Erion Braçe-** Pra, përgjegjësia për të gjithë këtë situatë ka qenë e byrosë shqiptare të Sigurimeve dhe e drejtorit të mbikëqyrjes?

**Ervin Koçi-** Ka qenë keqfunksionimi i Byrosë dhe mosndjekja dhe monitorimi korrekt nga Autoriteti për vite me radhë.

**Erion Braçe** Po këta njerëzit që e kanë pasur detyrë funksionale këtë gjë a mbajnë përgjegjësi, apo jo?

**Ervin Koçi**- Pa diskutim që mbajnë përgjegjësi, por drejtuesi në Autoritet ka ndryshuar shpeshherë që nga viti 2002 dhe është i pamundur të gjesh një përgjegjës për rastin konkret. Gjithsesi, problemi i madh është që Departamenti i mbikëqyrjes nuk e njihnte fare si përgjegjësi të tij që të mbikëqyrte byronë e sigurimeve. Kjo menjëherë ndryshoi, kemi caktuar një punonjës që të ketë përgjegjësi direkt.

**Erion Braçe** – Vazhdojmë me pyetjen tjetër. E kuptova, faji gjithmonë mbetet jetim.

**Ervin Koçi** -Në vite na është deklaruar se numri i konsiderueshëm i mjeteve motorike që qarkullojnë pa sigurim ndikon në rritjen e masës së fondit të kompensimit dhe si një ndër arsyet që siguronte rritjen e primit të sigurimit. Si është tendenca në këtë tregues?

Nëse mjetet që qarkullojnë pa sigurim janë duke u ulur, përse nga krahu tjetër kemi rritje të masës së fondit të kompensimit? A mos kemi të bëjmë me fenomene të tjera si informaliteti ose shitje jashtë sistemit?

Në fakt, këtë shqetësim e trajtuam edhe në seancën tjetër të pyetjeve. Sigurisht, numri i tyre është rritur drejtpërdrejt me masën e fondit të kompensimit për të çliruar dëmet, në rast se ato përfshihen në aksidente. Duhet të theksojmë se për dëmet e prapambetura fondi është rritur, siç e përmenda edhe në përgjigjet e pyetjeve më parë për shkak të vendimit të gjykatave, interesave ose shpenzimeve përmbartimore ose mos propogjionimit të saktë. Faktikisht, numri i mjeteve të pasiguruara ka ardhur duke u ulur me një përmirësim në krahasim me vitin 2016. Pra, është rritur numri i policave të sigurimit me 16 mijë mjete, ndërsa numri i mjeteve të regjistruara është ulur me mbi 27 mjete për shkak të amnistisë që bëri Kuvendi.

Sa u përket ngjarjeve objekt për kompensimin këto vitet e fundit tregon për një tendencë të uljeve të detyrimeve që vijnë nga fondi i kompensimit vit pas viti për shkak edhe të uljes së makinave të pasiguruara. Përveç vlerës së detyrimit që ndikon në fondin e kompensimit, veç makinave të pasiguruara, ndikon edhe rritja e shkallës së ndërgjegjësimit të konsumatorëve lidhur me të drejtat e tyre në rastet e përfshirjes në aksidentet automobilistike, sepse më parë njerëzit nuk e dinin që duhet të bënin padi në gjykatë ose të drejtoheshin te drejtoria për të marrë vlerat.

Së dyti, besoj se pjesa më e madhe e fondit të kompensimit janë dëme shëndetësore, që kapin vlerë shumë të madhe, ankimohen në gjykatë dhe, duke zgjatur afatin e trajtimit, rritet edhe

kostoja e tyre. Gjithashtu, edhe rritja e nivelit të pagës minimale i të ardhurave mesatare të punonjësve në Shqipëri kanë ndikuar në rritjen e vlerës së dëmshpërblimit.

Sa i përket rritjes që përballohet nga fondi i kompensimit, nuk mund të vlerësojmë sa ka ndikuar shitja jashtë sistemit, sepse, pavarësisht se i shet jashtë sistemit, nëse ka një policë sigurimi në momentin që ndodh aksidenti polica quhet e vlefshme nga policia dhe gjykata. Për këtë arsye ne u kemi kushtuar vëmendje të veçantë padive të regresit, duke kërkuar që këshilli i sigurimit të japë informacion mujor për këtë proces në një cikël që është bërë në vitin 2017. Njëkohësisht, kemi kërkuar nga shoqëritë që, kur të hapin paditë e regresit për të gjitha ngjarjet, të cilat nuk janë parashtruar për shkak se kishte shumë padi regresi ata nuk hapeshin nga shoqëritë.

Nga ana tjetër, vendosja e një numri unik për çdo policë duke filluar nga data 1 janar i vitit 2018, duke u hequr mundësinë që të përdoren policat e një viti më parë si dhe ndryshimi i rregullores për të përcaktuar qartë procesin e lëvizjes së policave të sigurimit dhe procesin e adresimit të tyre, ka ndikuar që në këtë të ulet shitja e pritsave jashtë sistemit. Në procesin e asgjësimit kemi kërkuar që të jetë edhe administrata tatimore.

Gjithashtu, autoritetet për eliminimin e shitjes jashtë sistemit, në tetor të vitit të kaluar, kanë marrë vendim që policat kufitare të shiten në sistemin online që më përpara nuk bëhej dhe nuk kërkohej nga shoqëritë e sigurimit.

Gjithashtu, kemi pasur kontakte të vazhdueshme me strukturat e kontrollit të trafikut rrugor, Policinë e Shtetit, të Kufirit, ku kemi kërkuar monitorimin e përmbushjes së këtij detyrimi dhe për të verifikuar rastet e shitjes së policave jashtë sistemit.

Nga muaji shtator i vitit të kaluar autoriteti dërgon në mënyrë periodike në formatin elektronik në Policinë e Shtetit informacione në lidhje me mjetet e transportit, të cilat nuk kanë sigurim të detyrueshëm të përgjegjësisë ndaj palëve të treta të vlefshëm ose për të cilët ka përfunduar ose nuk është rinovuar afati i kontratës brenda 14 ditëve.

Pyetja 14, a ka pasur në vëmendje dhe çfarë analizash ka bërë Autoriteti për veprimtarinë informale në tregun e sigurimeve, apo edhe në tregjet e tjera që mbikëqyrin, si për shembull, platformat *on-line* të tregtimit.

Si do të jetë situata? Çfarë masash janë marrë apo çfarë iniciativash kanë planifikuar?

Sipas ligjit të sigurimeve, transaksionet e kompanive të sigurimit duhet të kryhen me banka. Megjithatë, nuk mund të mohohet që shitjet e policave bëhen me *cash*, gjë që mbështet informalitetin.

A keni ndonjë program bashkëpunimi me organet tatimore në këtë drejtim? A nuk mendoni që është më e përshtatshme të pajisen pikat e shitjes së policave me kasa fiskale?

Veprimtaria informale për tërheqjen dhe mbikëqyrjen është në fokus të punës sonë dhe inspektimeve të herëpashershme që u bëjmë tregjeve, si dhe duke bashkëpunuar e shkëmbyer informacione me institucionet që duhet të finalizojnë këtë proces.

Sa i takon tregut të sigurimeve, kemi analizuar situatën dhe treguesit duke marrë masat e nevojshme, si dhe duke kërkuar bashkëpunim me institucione të tjera. Kështu, kemi kontaktuar zyrtarisht, si dhe kemi organizuar takime me Policinë e Shtetit, ku kemi kërkuar angazhimin e tyre për të hetuar shitjen e policave jashtë sistemit; kemi kërkuar nga shoqëritë që nëse kanë informacione, të na informojnë për subjekte apo ndërmjetës të caktuar; në muajin shtator të vitit 2017, kemi nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve në lidhje me inspektimet e përbashkëta me shoqëritë e sigurimeve dhe subjektet e tjera në mbikëqyrje të AMF-së dhe shkëmbimin e informacionit.

Në kuadër të kësaj marrëveshjeje, Autoriteti, me anë të dy shkresave, referuar Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, ka kërkuar bashkëpunimin për inspektime të përbashkëta midis Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve. Fokusi i këtyre inspektimeve do të jetë verifikimi në vend i policave të sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit duke konkluduar me inventarizimin e plotë të këtyre policave sipas shitjeve dhe gjendjes së tyre për periudhën e përcaktuar në këtë inspektim në kuadër të aksionit të informalitetit që ka ndërmarrë administrata tatimore.

Kërkesa për bashkëpunim është rikërkuar në datën 7 maj. Administratës tatimore u kemi kërkuar bashkëpunim për të kryer procesin e grumbullimit dhe asgjësimit të policave të sigurimit të pakonsumuara nga ana e shoqërive të sigurimit ndër vite me qëllim eliminimin e rrugëve të informalitetit. Jemi në pritje të përgjigjes nga administrata tatimore.

Sa u takon platformave *on-line*, që lidhen me tregun e letrave me vlerë, i kemi dërguar disa shkresa Policisë së Shtetit dhe këtë shqetësim e kemi ndarë me SHISH-in, Drejtorinë e Parandalimit të Pastrimit të Parave, Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve dhe kemi zhvilluar me disa prej tyre edhe takime dypalëshe.

Lidhur me pikën e dytë të pyetjes, ku i referoheni mënyrës së kryerjes së transaksionit që lidhet me pagesën e primit, në gjykimin tim, çdo pikë shitje policash duhet të pajiset me kasë fiskale, edhe pse mund të ketë një kosto të lartë për shoqëritë që kanë një numër të madh agjentësh blerjesh apo mirëmbajtjeje dhe, në dijeninë time, ka qenë pjesë e diskutimit nga administrata tatimore, e cila ka vendosur që policat të mos shiten me kasë, pasi vetë polica është një dokument tatimor.

Si iniciativa të planifikuara për tregun e sigurimeve në luftën kundër informalitetit janë: nënshkrimi i një marrëveshje me Drejtorinë e Shërbimeve të Transportit Rrugor, e cila nuk është pranuar prej tyre, pasi nuk dëshirojnë të luajnë rolin e agjentit. Gjithsesi, jemi duke diskutuar përsëri këtë çështje.

Plan veprimi të përbashkët me policinë dhe operatorët në treg.

Inspektime të përbashkëta me tatimet.

Përmirësimi i sistemit të monitorimit të lëvizjes së policave të sigurimit.

Ndryshimet ligjore që kemi paraqitur dhe dematerializimi i policave.

Për tregun e kapitaleve, përveç forcimit të bashkëpunimit me SHISH-in, me të cilin kemi filluar të bëjmë *work shop*-e apo edhe të ndajmë apo të marrim informacione të klasifikuara, pasi ne si institucion nuk e kishim këtë të drejtë, tani e kemi bërë këtë aplikim edhe me Policinë e Shtetit dhe Drejtorinë e Parandalimit të Pastrimit të Parave. Gjithashtu, kemi filluar një shkëmbim më të shpejtë dhe periodik me autoritetet homologe, të cilat ushtrojnë aktivitetin në Republikën e Shqipërisë, njëkohësisht edhe ndryshimet e reja ligjore për tregun e kapitalit, që besoj do të paraqiten në fund të vitit.

**Erion Braçe** – Nëse e kuptova mirë, pretendimi juaj është që polica e sigurimit është dokument tatimor?

**Ervin Koçi** - Ky ka qenë diskutimi që është bërë para disa vitesh nga administrata tatimore. Sipas informacionit që kam marrë, fillimisht u vendos të vendoseshin kasa, pastaj, pas ankesës që kanë bërë shoqëritë e sigurimit, kasa tatimore u hoq nga përdorimi.

**Erion Braçe** – Polica e sigurimit është një produkt shumë i qartë, nuk është dokument tatimor dhe pikërisht kjo situatë informaliteti, që ekziston në tregun e sigurimeve, duhet të marrë fund sa më shpejt të jetë e mundur. Pa asnjë diskutim, polica e sigurimit duhet të shitet me kasë fiskale, si çdo produkt tjetër në territorin e Shqipërisë. Do të jetë pjesë e rezolutës së këtij komisioni dhe kjo pikë as që diskutohet.



**Ervin Koçi** -Ne që nesër do t'i bëjmë një shkresë administratës tatimore dhe besoj që do të jetë në vullnetin e saj kjo pjesë.

**Erion Braçe** – Jo, kjo çështje nuk është me vullnet! Për sa kohë që administrata tatimore, çdo produkt ia nënshton kasës fiskale, pa asnjë lloj diskutimi që duhet të nënshtrohet edhe ky produkt. Kjo nuk është çështje vullneti, por është çështje formalizimi dhe ligjshmërie. Kush do të shesë jashtë kasës fiskale, të shkojë ta bëjë në një territor tjetër, jo në Republikën e Shqipërisë.

Për sa kohë që këtë ia kërkojmë çdo sipërmarrjeje të vogël, për më tepër që ky produkt lidhet me të gjitha ato fenomene për të cilat folëm deri tani, pa asnjë lloj diskutimi, ky produkt do t'i nënshtrohet kasës fiskale si çdo produkt tjetër në territorin e Republikës së Shqipërisë.

**Ervin Koçi** - Pyetja e radhës, duke pasur parasysh rekomandimin e dhënë në rezolutën e fundit për algoritmin e përdorur në shitjen e policës së sigurimit të detyrueshëm motorik, shtrohet pyetja: a u inspektua dhe u shqyrtua ky algoritëm?

Çfarë konkluzioni doli nga inspektimi në lidhje me garancinë që jep algoritmi i përdorur për të siguruar konkurrencën në treg? A i keni diskutuar këto konkluzione me Autoritetin e Konkurrencës apo keni ndërvepruar me këtë autoritet në ndonjë mënyrë tjetër?

Për sa i takon AMF-së lidhur me zgjidhjen e problematikës së konkurrencës në tregun e sigurimeve, siç ju kemi informuar, pas një verifikimi në sistem, kemi hequr IP-në e një brokeri nga sistemi i shitjeve që administrojnë AMF-ja dhe kemi mbikëqyrur në mënyrë të vazhdueshme nëpërmjet inspektimeve procedurat e tregtimit të policave të sigurimit të mjeteve motorike.

Në dijeninë tonë dhe sipas shkresave që na kanë ardhur, është kryer një hetim nga inspektorët e konkurrencës gjatë hetimit të tregut të sigurimeve në fund të vitit 2016, nga ku janë marrë disa masa rregullative nga Autoriteti i Konkurrencës sipas parashikimeve të ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës”. Ky hetim përkon me periudhën në të cilën ka dalë rezoluta e Kuvendit për AMF-në, dhe që nga prilli i vitit 2017, AMF-ja ka qenë në rol proaktiv duke bashkëpunuar me Autoritetin e Konkurrencës.

Ky bashkëpunim është kërkuar të intensifikohet nga ana jonë. Gjatë këtij viti i kemi nisur disa shkresa AK-së, përkatësisht shkresat me nr. protokolli 707, datë 20.02.2018, ku jemi shprehur që do të vlerësojmë hetimin në tregjet nën mbikëqyrje, dhe në shkresën nr. 1416/1, datë 27.04.2018, nisur nga një ankesë e depozituar në AMF, ia kemi kaluar për kompetencë Autoritetit të Konkurrencës, duke vlerësuar çdo hetim apo veprim nga ky autoritet.

Në një inspektim të fundit të AMF-së, në fund të prillit janë evidentuar disa të dhëna dhe fakte, të cilat u janë paraqitur institucioneve për veprime të mëtejshme në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe përgjegjësitë që përcakton ligji.

Ka ardhur përgjigje nga Autoriteti i Konkurrencës sot në mëngjes, që kërkon një informacion shtesë, të cilin do t'ia nisim sapo të shkojmë në zyrë. Meqenëse në këtë fushë është Autoriteti epror, në qoftë se janë të gatshëm, ne jemi edhe për inspektime të përbashkëta me të.

**Erion Braçe** – Përgjigja është tërësisht e paqartë! Pyetja ishte shumë e qartë: a është bërë inspektimi dhe a u shqyrtua ky algoritëm, që është përdorur deri ditën që ju keni ndërhyrë, apo jo?

**Ervin Koçi** - Ne bëmë verifikimin në sistem, hoqëm IP-në, ndërsa për algoritëm...

**Erion Braçe** –Më fal, kemi kërkuar me rezolutë inspektim, jo verifikim, dhe më lejoni t'ju them që e keni shkruar ju me dorën tuaj.

**Ervin Koçi** - Kam përshtypjen që është verifikim, kryetar.

**Erion Braçe** – Edhe një herë, e keni shkruar ju me dorën tuaj! Çfarë ndodhi?

**Ervin Koçi** - Bëmë verifikimin dhe hoqëm IP-në. Algoritmi është i pamundur që të...

**Erion Braçe** – Çfarë bënte IP-ja deri në momentin që e hoqët?

**Ervin Koçi** - Deri në momentin që e hoqëm ishte mbi kompanitë e sigurimit. Hoqëm IP-në dhe kemi lidhje vetëm me kompanitë e sigurimit.

**Erion Braçe** – Dua t'ju pyes drejtpërdrejtë: kjo IP që ndodhej në këtë algoritëm, çfarë i kishte shkaktuar tregut? Kishte pasur pasoja në treg?

**Ervin Koçi** - Këtë nuk mund ta gjykonim, sepse është e pamundur, kryetar.

**Erion Braçe** – Përse e hoqët atëherë?

**Ervin Koçi** – E hoqëm, sepse nuk kishim të drejtë të kishim një IP brokeri, por kishim të drejtë të ishim të lidhur vetëm me shoqëritë e sigurimit. Kjo kishte krijuar problemin që brokeri ishte mbi shoqëritë e sigurimit, ndërsa ne nuk kemi punë me brokerin...

**Erion Braçe** – Ky brokeri që ishte mbi shoqëritë e sigurimit, çfarë kishte bërë në treg?

**Ervin Koçi** –Nuk kishim mundësi, kryetar, të verifikonim algoritmin...

**Erion Braçe** – S'kishit asnjë lloj mundësie ta verifikonit?

E kupton çfarë dallimi është nga këtu, atje, drejtor? ...

Kur je këtu e di shumë mirë se çfarë ndodh, ndërsa kur je atje pastaj kthehet në amnezi totale.

**Ervin Koçi** – Jo, absolutisht, zoti kryetar, jam shumë i përgjegjshëm për këtë që po them, se ka një gjë, është e pamundur që ne të kemi mundësi ta verifikojmë. Ne këtë ia kemi kërkuar tashmë edhe Autoritetit të Konkurrencës, kërkojmë të bëjmë inspektime të përbashkëta nëse ai dëshiron për ta mbyllur këtë proces njëherë e mirë, sepse edhe në inspektimet e fundit kemi kapur probleme thelbësore që për hir të inspektimit që do të bëjmë, nuk do të jap informacion më shumë.

**Erion Braçe** - Jam shumë i qartë. Çdo gjë që ka ndodhur më përpara, fshihet! Vazhdojmë!

**Ervin Koçi** - Në raportimet për bashkëpunimin me rregullatorët e tjerë, veçanërisht me Bankën Qendrore të Kosovës deklarohet se ka pasur probleme. Konkretisht, ku konsistojnë problemet? Kush mban përgjegjësi për pengesat në zbatimin e këtyre marrëveshjeve? Çfarë masash keni marrë që të kapërcehen këto probleme?

Ju evidentuat Kosovën, pyetja është: po në Maqedoni si është situata, meqenëse edhe aty kemi prani të kompanive nga Shqipëria?

Në vijim të pyetjes së mësipërme, a e keni vlerësuar nëse problemet në këto tregje kanë ndikim për kompanitë “mëma” apo tregun në Shqipëri dhe çfarë impakti kanë? Çfarë mekanizmash dhe strukturash keni ndërtuar për mbikëqyrjen e grupeve?

Është e vërtetë se kemi pasur probleme të mbartura për zbatimin e memorandumit të mirëkuptimit midis autoritetit të Bankës Qendrore të Kosovës dhe Byrosë Shqiptare të Sigurimit. Në funksion të zbatimit të lëvizjes së lirë të qytetarëve të të dy vendeve ka hyrë në fuqi që nga viti 2001 ky memorandum mirëkuptimi, i cili është rishikuar në tetor të vitit 2006, ku mjetet ndërmjet dyja vendeve kalojnë pa policë kufitare.

Marrëveshja e mirëkuptimit është lidhur me qëllim njohjen reciproke të certifikatave të policave të sigurimit të detyrueshme të përgjegjshësisë ndaj palëve të treta, me të cilën nënkuptohet se ato mjete që janë të regjistruara në Kosovë mund të qarkullojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë pa policë sigurimi shqiptare dhe anasjelltas një qytetar me policë sigurimi nga autoritetet shqiptare në Shqipëri mund të qarkullojë në Kosovë pa policë sigurimi. Për trajtimin dhe pagesën e dëmeve parashikohet se secila palë do të trajtojë dhe do të paguajë dëmet që janë adresuar në baza të njëjta, siç edhe paguhen, sipas legjislacionit të sigurimit të detyrueshëm në fuqi të vendit të aksidentit.

Autoriteti ka sot këto problematika të mbartura nga viti 2006 lidhur me zbatimin e këtij memorandum, të cilët janë : nga Byroja e Sigurimit të Kosovës kërkohet shlyerja e detyrimeve që kanë shoqëritë e sigurimit dhe pretendohet se këto detyrime kapin vlerën prej 900 mijë...

**Erion Braçe** - Afroni pak mikrofonin!

Nuk e kuptova këtë. Çfarë ka ndodhur? Çfarë ka konstatuar Autoriteti?

**Ervin Koçi** – Janë problematika të mbartura që nga viti 2006.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Nga Byroja e Sigurimit të Kosovës është kërkuar që të shlyhen detyrimet që kanë shoqëritë e sigurimit dhe pretendohet se këto detyrime kapin vlerën prej 900 mijë eurosh. Nga Byroja shqiptare e Sigurimit cilësohet se nga pala kosovare ka probleme lidhur me njohjen e detyrimeve që janë vendime gjyqësore të formës së prerë dhe detyrime që sipas Byrosë kosovare ka të përfshirë interesa, *feen*-ë e trajtimit, pagesën që duhet të kryet nga korrespondentët, sepse nuk ka një rakordim për përcaktimin e saktë të detyrimit.

Sipas Byrosë sonë shqiptare detyrimi i shoqërive kosovare rezulton të jetë me vlerë më të madhe se detyrimi që kanë shoqëritë shqiptare.

Shqetësim tjetër i byrosë shqiptare është mosnjohja e korrespondentit nga byroja kosovare. Faktikisht kjo është një marrëveshje midis dy byrove dhe nuk ka forcën e ligjit. Ky është një problem shumë i madh, sepse nuk është ratifikuar as nga parlamenti as ka ndryshime ligjore. Kjo ka bërë që shoqëritë ta shfrytëzojnë këtë handikap që është krijuar që nga viti 2006. Kjo e bën të domosdoshme nevojën për ndryshime ligjore, me qëllim rishikimin total të këtyre kontratave. Gjithsesi, në muajin dhjetor, sa jam vënë në dijeni të kësaj suate, kam organizuar një takim të përbashkët me Autoritetin e Kosovës dhe Bankën Qendrore, Byronë e Kosovës dhe Byronë e Shqipërisë ku bëmë një plan pune për ta zgjidhur këtë çështje sa më shpejt të jetë e mundur, ishte brenda muajit mars, por jemi ende në proces, sepse nuk po rakordojnë shoqëritë shqiptare dhe ato kosovare për dëmin. Aty lamë dy detyra kryesore.

E para, ishte që byrotë respektive të bëjnë mbylljen e rakordimeve të akumuluar për përcaktimin e detyrimeve për secilën palë, për detyrimet e lindura Byroja kosovare e Sigurimit dhe Byroja shqiptare e Sigurimeve të përdorin të njëjtin standard vlerësimi. Pas përfundimit të rakordimit të fillojë procesi i shlyerjes ndaj qytetarëve, si dhe të hartohet një memorandum mirëkuptimi i ri midis palëve. Për këtë ne bëmë si Autoritet një memorandum të ri, e dërguam

në Autoritetin e Kosovës. Pak a shumë kemi rënë dakord dhe mendojmë që këtë ose ta kalojmë të ratifikohet në parlament që të ketë fuqi ligjore, në mënyrë që të jetë e detyrueshme, që një policë shqiptare të ketë vlerë në Kosovë dhe anasjelltas, sepse nesër çdo shoqëri shqiptare shkon në gjykatë dhe me të drejtë thotë: “Unë nuk e marr përsipër këtë detyrim, sepse polica shqiptare njihet vetëm në territorin e Republikës së Shqipërisë”, sepse kështu shënohet edhe në ligj, edhe në kushtet e kontratës që ka vendosur shoqëria e sigurimit.

Në datën 26 prill është zhvilluar një takim në Prizren me përfaqësues të dy byrove për të diskutuar për detyrimet dhe mosmarrëveshjet që kanë lindur për pagesat e dëmeve. Besoj se sipas informacioneve që na ka dhënë byroja jonë janë në fazën përfundimtare për të mbyllur dhe për të rakorduar përfundimisht detyrimet, sepse byroja kosovare përdorte interesat dhe *feet-ë* e saj, ndërsa byroja jonë nuk përdorte interesat dhe *feet-ë*, por vetëm vlerën që kishte dalë nga vendimi i gjykatës ose vlera që kishte dalë nga vlerësimi i dëmit nga vlerësuesi.

Besoj brenda këtyre muajve do ta mbyllim përfundimisht këtë proces, që ka qenë problematik që nga vitit 2006, jo vetëm për shlyerjen e dëmeve, por për t’u dhënë një zgjidhje ligjore çështjes që të mos përsëritet më në të ardhmen. Këtë problematikë nuk e kemi me Maqedoninë për arsye, sepse në Maqedoni ne operojmë me polica kufitare. Pra, në të dyja vendet ne nuk operojmë me lëvizje të lirë të mjeteve dhe të drejtuesve të tyre.

Për sa i përket mbikëqyrjes që bëhet në bazë grupi, pasi kompanitë “bija” mund të kenë ndikim në kompanitë “mëmë” Autoriteti në llogaritjen e treguesve financiarë të kompanive “mëmë” në Shqipëri zbaton të gjitha standardet ndërkombëtare të mbikëqyrjes dhe raportimit financiar, duke përfshirë të gjitha efektet e kompanive “bija”, apo edhe degët jashtë territorit të Shqipërisë.

Në kuadër të marrëveshjes së mirëkuptimit midis Autoritetit dhe Bankës Qendrore të Kosovës me qëllim mbikëqyrjen efektive të grupeve të sigurimit që ushtrojnë aktivitet në të dyja vendet: në Shqipëri dhe në Kosovë, gjatë vitit 2017, përfaqësues të AMF-së morën pjesë në një inspektim të përbashkët me BQK-në pranë shoqërive të sigurimit që veprojnë në Kosovë, pjesë e grupeve të sigurimit me qendër në Shqipëri. Edhe pas kësaj periudhe ne kemi një kontakt dhe komunikim të vazhdueshëm me BQK-në. Nesër do të jemi përsëri në Kosovë për të diskutuar dy çështje, një prej tyre është edhe problemi i mbartur për detyrimet që kanë qytetarët e dy vendeve dhe njëkohësisht për të administruara më mirë rrezikun që vjen nga ushtrimet e veprimtarive të grupit të sigurimit. Ne kemi miratuar edhe një rregullore, në mesin e vitit të

kaluar për të përcaktuar kushtet dhe kërkesat për realizimin e mbikëqyrjes së grupit të sigurimit, me qëllim administrimin e rrezikut që rrjedh nga ushtrimi i veprimtarisë së grupit të sigurimit. Kjo rregullore ka hyrë në fuqi më 1 janar të këtij viti. Tashmë ne jemi edhe në kuadër të strategjisë sonë 5-vjeçare (2018-2022), duke krijuar një strukturë të dedikuar për mbikëqyrjen e grupeve të sigurimit me frymën edhe të direktivës së *Solvency II*.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Erion Braçe** - Keni vlerësuar nëse problemet në këto 3 tregje kanë ndikim për kompanitë “mëma” apo tregun në Shqipëri? Çfarë impakti kanë? Bëhet fjalë për “bijat” e kompanive “mëma” që janë në Shqipëri. Unë dua të di: cilat janë kompanitë që kanë detyrime në vendet respektive? “Mëmat” këtu dhe “bijat” atje. Sa janë këto detyrime, edhe në Kosovë, por veçanërisht në Maqedoni?

**Ervin Koçi**- Së pari, marrëveshja është midis byrove.

**Erion Braçe**- Edhe një herë, nuk të pyeta për marrëveshjen midis dy byrove, por të pyeta dhe jam shumë i interesuar për marrëdhënien midis jush si Autoritet i Mbikëqyrjes Financiare dhe dy autoriteteve respektive: Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare të Kosovës dhe të Maqedonisë. Nga informacioni që këmbeni me këto dy autoritete, cila është gjendja e kompanive “bija” të “mëmave” që janë në Shqipëri, në raport me detyrimet dhe me çdo element tjetër që i detyron ligji atje, duke filluar nga mjaftueshmëria e kapitalit, tek aftësia paguese dhe çdo gjë tjetër?

**Ervin Koçi** – Për pyetjen e parë e kam parë në këndvështrimin vetëm të marrëveshjes...

**Erion Braçe** – E paskeni parë gabim.

**Ervin Koçi** – Kryetar, po ju kthej përgjigje tani, sepse e kemi informacionin.

Së pari, kemi një bashkëpunim shumë të mirë tashmë edhe me Kosovën, edhe me Maqedoninë...

**Erion Braçe** – Drejtor, flisni për këtë çështje. Nuk më duhet bashkëpunimi i mirë që keni, më duhet bashkëpunimi konkret në funksion të kësaj çështjeje.

**Ervin Koçi** – Shkëmbejnë informacion, pothuajse çdo tremujor, edhe takime dypalëshe, kur kanë ardhur dhe kemi shkuar në takimet homologe.

Për sa i përket marrëveshjes me Kosovën, për sa i përket marrëveshjes së bashkëpunimit, të gjitha shoqëritë shqiptare dhe të gjitha kompanitë kosovare kanë detyrime. Për sa u përket

kompanive që janë bija ose filiale në Kosovë e në Maqedoni, dy kompani kanë problematika të theksuara me Autoritetin e Kosovës.

**Erion Braçe** – Çfarë do të thotë: “të theksuara”?

**Ervin Koçi** – Që kanë probleme me aftësinë paguese dhe janë nën masa mbikëqyrëse nga Autoriteti i Kosovës.

**Erion Braçe** – Pra, dy kompani bija të kompanive mëma...

**Ervin Koçi** – Njëra kompani është bijë, ndërsa tjetra filial.

**Erion Braçe** – Të dy kompanive mëma në Shqipëri, kanë probleme të theksuara me Autoritetin Mbikëqyrës të Kosovës.

**Ervin Koçi** – Po.

**Erion Braçe** – Cili është impakti i tyre këtu, në tregun shqiptar? Cili është raporti që kanë me ju? Sepse, në qoftë se kanë probleme të theksuara me Kosovë, cilat janë problemet që kanë me juve?

**Ervin Koçi** – Pa diskutim që këto janë reflektuar ndjeshëm edhe në Shqipëri, sidomos kur kompania në Kosovë është degë, sepse problematika e degës transferohet automatikisht te kompania mëmë, ndryshe nga filiali, i cili është brenda juridiksionit të vet. Ne jemi duke e ndjekur vazhdimisht dhe i kemi vënë nën masa të forta mbikëqyrëse. Njëkohësisht, ky që kemi në Kosovë është pjesë e një takimi që theksova pak më përpara, për të diskutuar këtë çështje.

**Erion Braçe** – Në qoftë se kanë impakt apo në qoftë se kanë situatë qoftë të mjaftueshmërisë kapitale, qoftë të aftësive paguese në Kosovë, çfarë po mbikëqyrni ju në Shqipëri, sepse s’e kuptoj? E kanë këtë problem në Shqipëri apo nuk e kanë këtë problem.

**Ervin Koçi** – Kanë të njëjtin problem në Shqipëri.

**Erion Braçe** – E kanë këtë problem në Shqipëri. Po. Cila është vendimmarrja juaj?

**Ervin Koçi** – Urdhëro?

**Erion Braçe** – Cila është vendimmarrja juaj për këtë rast?

**Ervin Koçi** – Në kemi marrë vendimmarrje, përveçse shtim kapitali, njëkohësisht kemi marrë masa për kufizime shpenzimesh, kemi kërkuar të shiten aksionet; u kemi dhënë ca afate kohore, e në qoftë se këto nuk realizohen brenda një periudhe kohore, do të kalojmë në një vendim të ashpër.

Njëkohësisht, i njëjti problem është edhe me Maqedoninë, ku një shoqëri ka një problem me aftësinë paguese, sipas një komunikimi që kemi pasur tremujorin e parë me Autoritetin homolog të Maqedonisë.

**Erion Braçe** – Na i tregoni ato vendimet apo masat që keni marrë ju.

**Ervin Koçi** – Çdo muaj ne bëjmë...

**Erion Braçe** – Janë zbatuar apo jo, drejtor?

**Ervin Koçi** – Po pra, këtë po them, kryetar.

**Erion Braçe** – I kanë zbatuar kompanitë, apo jo?

**Ervin Koçi** – Çdo muaj, më datë 20, ne shikojmë realizimin e muajit paraardhës...

**Erion Braçe** – Dhe si ju ka rezultuar?

**Ervin Koçi** – Janë realizuar pjesërisht.

**Erion Braçe** – Pjesërisht? Për çfarë flasim atëherë? Për çfarë po diskutojmë? Sepse ju mbeti, apo ju kthye në problem ajo që thashë këtu javës që shkoi. Këtë çështje kisha parasysh. Nuk kisha parasysh ndonjë çështje tjetër. Këtë çështje kisha parasysh, dhe po jua përsëris edhe një herë: o rivendosni autoritetin e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare në këtë treg, që ka një problematikë të theksuar me ligjshmërinë, ose pastaj, ju dhe ne, ta lëmë këtë punë dhe ta themi publikisht se nuk e bëjmë dot.

Në qoftë se ju merrni vendime, dhe një byro, që është në kushte paligjshmërie, nuk i zbaton ato; në qoftë se ju merrni vendime, dhe një kompani që është në kushte skandaloze në raport me ligjin, apo dy, tre, këtu, në Kosovë apo në Maqedoni, nuk i zbatojnë ato, atëherë çfarë kuptimi ka që ekziston Autoriteti? Çfarë kuptimi ka, që ju raportoni këtu? Çfarë kuptimi ka, që ne bëjmë rezoluta? Çfarë kuptimi ka që ne ju japim mbështetje juve? Çfarë kuptimi ka, që ne ju shtyjme juve të çoni deri në fund vendimmarrjen tuaj? Çfarë kuptimi kanë të gjitha këto? S'kanë asnjë lloj kuptimi. E në fund fare, çfarë kuptimi ka, që qytetarët të shkojnë dhe të presin policën e sigurimit? Çfarë kuptimi ka, kur janë fare të paqartë? Prandaj jua kërkova atë informacionin e thjeshtuar, që duhet të jetë në faqen tuaj zyrtare. Jo në faqet e kompanive, por në faqen tuaj zyrtare. Çfarë kuptimi ka për qytetarët, në këtë pikë, që paguajnë për të marrë këtë shërbim? E kur vjen puna, kompanitë tek të cilat paguajnë janë në këtë situatë, qoftë financiare, qoftë edhe ligjshmërie, në raport me Autoritetin Mbikëqyrës Financiar, por edhe në raport me qytetarët.

Ka pyetje të tjera, apo jo? Se kjo pyetje më përpara u bë e qartë.



**Pajtim Melani** – Lidhur me pyetjen shtatëmbëdhjetë, raportohet se bordi ka marrë masën e heqjes së licencës për Stock International Albania në këtë proces. Çfarë masash u morën për të mbrojtur investitorët dhe a janë vlerësuar humbjet që mund të kenë pësuar ata?

Po, sigurisht që është e vërtetë, dhe unë e raportova se bordi ka marrë edhe masat mbikëqyrëse, me këtë rast të revokimit të licencës për Stock International Albania. Duhet theksuar se Stock International Albania kishte dy licenca: një për veprimtari brokerimi, një si agjent, për llogari të platformës stock.com, e cila administrohej nga brokeri Lead Capital Market Ltd.

Qëkur është shfaqur problemi i platformave të drejtimit *online*, e kam ngritur çështjen në cilësinë e anëtarit të Grupit Këshillimor të Stabilitetit Financiar, i cili drejtohet nga ministri i Financave, ku merr pjesë edhe guvernatori, e ku ligjërisht jeni i ftuar edhe ju, si kryetar i Komisionit të Ekonomisë...

**Erion Braçe** – Për fat të keq apo të mirë, quajeni si të doni, nuk kam marrë pjesë në asnjë mbledhje, sepse s’ më ka njoftuar e as më ka ftuar njeri deri më sot. Vazhdojmë!

**Pajtim Melani** – Flas për aq sa unë kam kërkuar.

**Erion Braçe** – Në rregull pra!

**Pajtim Melani** – Në këtë mbledhje, ne kemi diskutuar, sepse çështja e platformave nuk është çështje ekskluzive e AMF-së, po përkundrazi, çdo gjë kryhet nëpërmjet sistemit bankar, qoftë edhe kartave të kreditit, e për t’i dhënë ndërgjegjësimin e duhur. Pas asaj mbledhjeje të Grupit Këshillimor të Stabilitetit Financiar, është dalë me deklaratë për shtyp nga tre institucionet. Jemi munduar, e dhe publikisht, t’i bëjmë qytetarët të ndërgjegjësuar që janë platforma me risk shumë të lartë.

Nga pikëpamja e veprimeve ekzekutive, pas inspektimit të bërë në shoqërinë Stock International Albania, i kemi revokuar të dyja licencat, siç thashë. Për të qenë të drejtpërdrejtë me pyetjen se çfarë masash kemi marrë për investitorët, ne i kemi kërkuar Stock International Albania - s, që brenda 20 ditëve pas inspektimit të depozitonte informacionin për njoftimin e të gjithë klientëve të vet në lidhje me ndërprerjen e aktivitetit, vendimin e asamblesë dhe vendimin e këshillit në lidhje me situatën e shoqërisë. Kemi vënë një gjobë, siç parashikon ligji, në masën 100 mijë lekë ndaj administratorit, dhe në mbledhjen e menjëhershme të radhës, pasi që këto masa nuk qenë marrë, i kemi revokuar licencën.

Investitorët shqiptarë që janë kontaktuar për marketing nga kjo platformë, kanë humbur zero lekë, ose zero euro. Pse? Sepse e gjithë veprimtaria ka qenë e administruar nga Lead Capital dhe jo nga Stock International dhe gjithçka është zhvilluar jashtë territorit të republikës së Shqipërisë.

Nga kjo pikëpamje, besoj se në vijim të kësaj pyetjeje dhe të pyetjes tetëmbëdhjetë, nëse e kemi paraqitur këtë si veprim pozitiv, përgjigja është po, sepse, në gjykimin tim, pavarësisht nëse bëjnë agentin apo brokerin, këto shoqëri është më mirë të jenë të mbikëqyrura e të rregulluara nga AMF, se sa të jenë jashtë juridiksionit e jashtë rregullimit. Kjo është në parim. Gjithsesi, në total janë dhënë vetëm pesë licenca për gjithë periudhën 2011 – 2017.

Duke marrë në konsideratë çfarë është e rëndësishme për ta mbikëqyrur këtë, ne kemi marrë disa masa në lidhje me forcimin e masave rregullative sa i takon licencimit të tyre. kështu, po punohet për një ligj të posaçëm për instrumentet financiare, në përputhje me direktivat e BE-së, gjë që po bëhet nga ekspertët e huaj. Po shtohen kërkesat për informacion plotësues gjatë procesit të licencimit, po komunikohet me autoritetet homologe. Duhet thënë se shumë nga këto shoqëri janë me kompani mëmë në vende të huaja, si Italia, Qipro a vende të tjera. Gjithashtu, po bëhet monitorimi *in sight*, me analiza vjetore, periodike tremujore dhe inspektimi në vend. Për shembull, në muajin maj të këtij viti AMF ka ndërmarrë një inspektim të përbashkët me Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave për veprimtarinë e këtij lloji.

Në qoftë se ka detaje të tjera, jam i gatshëm.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Ervin Koçi** – Pyetja e radhës, në vijim të pyetjes së mëparshme, duke shqyrtuar aktivitetin e gjerë licencues në këtë treg, si dhe faktin që edhe licencimi i Stock International Albania u paraqit si një veprim pozitiv për tregun e ndërmjetësve, ndërkohë që për pak vjet iu hoq licenca, çfarë masash keni marrë që të garantohet procesi i licencimit dhe të mos përsëriten përvoja të tilla?

Në lidhje me masat për përmirësimin e aktivitetit të licencimit ne kemi marrë disa masa: si përmirësimi i kodit ligjor dhe rregullativ. Po punohet për një ligj të ri në tregun e instrumenteve financiare në përputhje me direktivat e BE-së për respektimin e kërkesave të licencimit.

E kemi vënë theksin te kërkesa për informacion plotësues gjatë dhe pas procesit të licencimit, sidomos në paraqitjen e një plani biznesi sa më real në analizën e situatës financiare të aksionerit, si dhe me sjelljen e shoqërisë në tregjet ku ajo ka operuar.

Njëkohësisht, kemi një komunikim me ATT-të homologe, të vazhdueshëm, për çdo licencim që ne marrim dhe një opinion nga autoriteti përgjegjës mbi sjelljen e shoqërisë së huaj të prokurimit. Njëkohësisht, bëjmë një analizë të riskut për të parë risqet që bart aktiviteti që do të licencohet, si dhe kryejmë inspektime që i nisëm për herë të parë nga viti i kaluar, gjatë procesit të licencimit për të parë, së pari, infrastrukturën dhe mënyrën e operimit të kësaj kompanie.

Njëkohësisht, ne monitorojmë në mënyrë të vazhdueshme shoqëritë e licencuara, dhe kjo nënkupton jo vetëm përmes analizave dhe raporteve vjetore periodike, por edhe inspektime në vend.

Tashmë ne jemi duke inspektuar të gjitha këto shoqëri bashkë me Drejtorinë e Parandalimit dhe Pastrimit të Parave.

Gjithashtu, ne jemi konsultuar edhe me ekspertët, të cilët kanë gati 2 vjet që asistojnë në zhvillimin e tregut të kapitalit në Shqipëri.

Në lidhje me faktin që të mos përsëriten përvoja të tilla, që pa diskutim ndikojnë edhe në besimin që krijon investitori në treg, ne po tregojmë kujdes maksimal në licencimin e këtyre subjekteve, megjithatë revokimi i licencës së këtyre lloj subjekteve apo edhe falimentimi i tyre mund të ndodhin në të ardhmen, por e rëndësishme është që të jetë gjithmonë i mbrojtur investitori.

Autoritetet homologe të mbikëqyrjes në mënyrë që investorët të mos preken, nuk i lejojnë shoqëritë e brokerimit, që kanë licencuar, të mbajnë asete në kujdestari, që do të thotë që brokeri nuk ka të drejtë të regjistrojë në një llogari të përbashkët dhe të kujdeset për asetet e klientëve.

Këtë aktivitet e kryejnë vetëm bankat, ndërsa në rastin e aktivitetit të agentit të lidhur, këtë aktivitet e kryen brokeri i licencuar nga vendet e BE-së, të cilët kanë standarde shumë të larta në lidhje me ndarjen e aseteve.

Ligji i ri për tregjet dhe instrumentet financiare, i cili po hartohet nga ekspertët e projektit SECO, parashikon edhe krijimin e një fondi të mbrojtjes së investorëve, i cili kompenson investorët në rast se ato do të mashtrohen nga brokerat.

Pyetja 19: Në raportimet e AMF-së në vitet e fundit, për disa vjet rresht jemi informuar që janë përgatitur amendimet e ligjit të fondeve të pensioneve private vullnetare, me mbështetje të Bankës Botërore. Në ç'fazë është ky ligj, dhe përse nuk është arritur të paraqitet në Kuvend?

Në vitin 2016 Ministria e Financave ka dërguar për miratim në KM projektligjin, duke sjellë në vëmendje edhe ndryshimet që i ka bërë variantit të dërguar nga AMF-ja. Në fund të vitit 2017, u risoll nga Këshilli i Ministrave draft-ligji për koordinim përfundimtar me Bankën e Shqipërisë. Kjo e fundit, është shprehur pa komente mbi draftin final. Sqaroj se, projekti dhe relacioni që u paraqit në KM në dhjetor të viti 2016, kishte ndërhyrje vetëm në tekstin e relacionit për të pasqyruar emërtimin e ri të ministrisë.

Pyetja 20: Përveç problematikave të paraqitura mbi bazë tregjesh, si është prirja e ndërthurjes së veprimtarive dhe operatorëve të tregjeve të ndryshme që i keni në mbikëqyrje dhe me këtë rast si i shqyrtoni risqet e integruara?

Trajtimi i rreziqeve të integruara në raport me Sistemin Bankar.

Në raport me trajtimin e rreziqeve të integruara me Sistemin Bankar, Autoriteti komunikon vazhdimisht me Bankën e Shqipërisë në rastet kur bankat apo subjektet nën mbikëqyrjen e Bankës së Shqipërisë, përfshihen në proceset licensuese apo autorizuese të Autoritetit. Përveç rasteve të licensimit, Autoriteti komunikon me Bankën e Shqipërisë edhe në rastet e miratimit të prospektit të obligacioneve me ofertë private, në rastet kur emetuesi është banke ose institucion financiar i licencuar nga Banka e Shqipërisë.

Strukturat e brendshme të Autoritetit mbajnë kontakte dhe komunikim të vazhdueshëm me Bankën e Shqipërisë në lidhje me problematikat që mund të dalin si rrjedhojë e aktivitetit të subjekteve ku aksioneri kryesor është Bankë. Autoriteti gjatë vitit 2017 ka kryer edhe një inspektim të përbashkët me Bankën e Shqipërisë në lidhje me transparencën që u ofrohej investitorëve të agjentët e shitjes të produktit të fondeve të investimit pranë degëve të një banke.

Trajtimi i rreziqeve sistemike.

Autoriteti trajton me seriozitet çdo rrezik që mund të ketë potencial për t'u shndërruar në rrezik sistematik. Këto rreziqe raportohen rregullisht në mbledhjet e Grupit Këshillimor të Stabilitetit Financiar. Për adresimin e rreziqeve sistemike në GKSF, Autoriteti ka miratuar edhe rregulloren e brendshme të "Mbikëqyrjes në raste krizash", ku trajtohet me seriozitet përshkallëzimi i problematikave që mund të lindin nga institucionet e mbikëqyrura, si dhe procedura e përshkallëzimit në GKSF. Së shpejti, me ndihmën e ekspertëve të SECO-s,

Autoriteti do të organizojë edhe një simulim “krize”, së bashku me pjesëmarrës të tjerë nga Ministria e Financave, ASD-ja dhe Banka e Shqipërisë për të parë qëndrueshmërinë e stabilitetit financiar (më 1 qershor, pas dy javësh).

Trajtimi i rreziqeve të integruara në nivel Autoriteti (të brendshëm).

Produktet e sigurimit të jetës që tregtohen në Shqipëri janë produkte të thjeshta dhe nuk janë të lidhura me investime në tregjet e kapitaleve, duke bërë që ndërthurja e risqeve midis tregjeve të jetë inekzistente.

Megjithatë, strukturat e Autoritetit bashkëpunojnë midis tyre në lidhje me shpërndarjen e informacionit dhe dhënien e opinioneve midis drejtorive, duke nisur që nga licencimi i subjekteve të reja, miratimi i ndryshimeve në dokumentacionin e subjekteve të mbikëqyrura deri në ndarjen e informacionit në përfundim të analizave financiare të subjekteve që zotërojnë operatorët në tregje të ndryshme të mbikëqyrura nga AMF-ja, midis departamenteve të mbikëqyrjes së tregjeve të ndryshme.

Trajtimi i rreziqeve të integruara që lindin si rrjedhojë e transaksioneve me palë të lidhura, për të adresuar më mirë konfliktet e interesit.

Për më tepër në lidhje me ndërthurjen e operatoreve të ndryshëm financiarë, si aksionerë të shoqërive administruese të fondeve të investimit AMF, në mënyrë që të monitorojë transaksionet midis shoqërive administruese dhe mëmës së tyre apo dhe me operatorët e tjerë financiarë në treg, në shkurt 2018 ka miratuar rregulloren “Mbi transaksionet me palët e lidhura dhe/apo palët që i përkasin të njëjtit grup financiar”, objekti i së cilës është vendosja e rregullave për transaksionet e portofolit të sipërmarrjeve të investimeve kolektive, të kryera me palë të lidhura dhe/apo palët që i përkasin të njëjtit grup financiar, në emër ose drejtpërdrejtë me subjektet e përcaktuara si palë e lidhur me shoqërinë e administrimit të SIK, si dhe me depozitarin e fondit të investimit ose sipërmarrjen e investimeve kolektive.

Pyetja 21: Vërejmë që edhe bankat po shtrihen në tregjet financiare që mbikëqyr AMF-ja dhe kanë marrë licenca të ndryshme. Në këtë proces si po ndërveproni me Bankën e Shqipërisë për të siguruar mostransferim të panevojshëm të rreziqeve nga një treg në tjetrin?

Duke iu kthyer përsëri raportimeve të AMF-së në komision, në ç’fazë është hartimi i protokollit të mbikëqyrjes së konsoliduar me Bankën e Shqipërisë dhe zbatimi i tij?

Në tregun e sigurimeve në vitin 2017 operojnë 3 banka me veprimtari brokerimi. Sipas nenit 204, pika 5, të Ligjit 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, veprimtaria e

brokerimit mund të kryhet edhe nga bankat, pasi të kenë marrë më parë miratimin nga Banka e Shqipërisë, si një nga kërkesat ligjore të licencimit të tyre. Aktualisht, Autoriteti është në procesin e inspektimeve në bankat broker për të siguruar respektimin e kërkesave ligjore në fuqi, veçanërisht në drejtim të transparencës me konsumatorin me qëllim eliminimin e konflikteve të mundshme të interesave financiare të bankës si ndërmjetës në sigurime dhe interesave të klientëve që dëshirojnë të përfitojnë një shërbim ndërmjetësimi të paanshëm, të drejtë.

Licencat e bankave me tregun e kapitaleve.

Në tregun e kapitaleve në vitin 2017 operojnë 17 shoqëri brokerimi në tituj, nga këto 10 janë banka, 5 banka depozitare, tri prej tyre kanë licencën e depozitarit të fondeve të pensionit dhe dy prej tyre kanë licencën e depozitarit të fondeve të pensionit dhe investimit. Gjithashtu, janë të licencuara dhe 9 banka si kujdestarë të titujve të qeverisë, si dhe 3 banka si kujdestare të obligacioneve të shoqërive.

Për sa i përket licencimeve të reja në këtë treg gjatë vitit 2017, Autoriteti ka dhënë miratimin për ushtrimin e aktivitetit të depozitarit të fondeve të investimit për një bankë tjetër të nivelit të dytë, duke përmbushur edhe një rekomandim të FMN-së të vitit 2017. Autoriteti ka dhënë licencën vetëm pas miratimit nga Banka e Shqipërisë për aktivitetin e depozitarit për bankën. Për më tepër, Autoriteti ka miratuar emetimin e obligacioneve me ofertë të një banke në vitin 2017. Në të gjitha rastet është komunikuar me Bankën e Shqipërisë për këto miratime.

Ndërveprimi me Bankën e Shqipërisë në lidhje me mostransferimin e panevojshëm të rreziqeve.

Gjatë vitit 2017 është zhvilluar edhe një inspektim tematik i përbashkët me Bankën e Shqipërisë mbi praktikën e shitjes së fondit të investimit

Draftprotokolli i Mirëkuptimit.

Është përgatitur draftprotokolli i bashkëpunimit të mbikëqyrjes së konsoliduar me Bankën e Shqipërisë nga ekspertët e FSVK. Ky draftprotokoll i është dërguar për opinion dhe komente Bankës së Shqipërisë. Ky protokoll pritet të finalizohet pas dakordësimit të këtij drafti dhe shndërrimit të tij në një marrëveshje dypalëshe për institucionet.

Marrëveshje me Bankën e Shqipërisë, Ministrinë e Financave dhe ASD-ja për Shmangien e Rrezikut Sistemik.

Për këtë jo vetëm që kemi takime 3-mujore të grupi këshillues “Objekt financiar”, por edhe takime të përbashkëta.

Gjithashtu, në kuadër të projektit “Forcimi i kapaciteteve mbikëqyrëse të Autoritetit me fokus: zhvillimin e tregut të kapitaleve”, ne kemi miratuar rregullat e brendshme për menaxhimin e krizave potenciale në tregjet e mbikëqyrura. Njëkohësisht i kemi propozuar GKSF-së përmirësimin e kësaj marrëveshjeje, në mënyrë që të kemi një mbikëqyrje më plotë, më të sigurt dhe më transparente për rastet kur një operator mund të shfaqë risqe në treg. Në dhjetor të vitit të kaluar ne kemi miratuar edhe procedurën e brendshme “Për menaxhimin e krizave”, duke bërë një simulim në AMF, bashkë me ekspertët e Bankës Botërore, për të parë reagimin e Autoritetit në qoftë se do të kishim një rast krize.

Pyetja tjetër: mund të shpjegoni më hollësisht në ç’mënyrë u kapërcye kontradikta ndërmjet ekzekutivit dhe bordit të AMF?

Kjo çështje paraqet mjaft rëndësi për mirëfunksionimin e AMF-së dhe ishte një ndër argumentet që bëri që Kuvendi të veprojë sipas kërkesave ligjore me shkarkimin e ish-drejtorit të Përgjithshëm. Ajo që ka rëndësi është: çfarë masash janë marrë për të integruar dhe siguruar bashkëpunim ndërmjet pjesës së punonjësve, që ruajtën integritetin e institucionit, dhe bordit.

Problematikat e krijuara për çështje kompetencash dhe bashkëpunimi midis ekzekutivit dhe bordit të AMF kishin krijuar një klimë konfliktuale, që ishte transferuar tek i gjithë stafi i Autoritetit. Për të ndryshuar këtë klimë ne zbatuam tri pikat e rezolutës së Kuvendit në funksion të kësaj marrëdhënieje. Njëkohësisht, kemi rregulluar edhe disa rregullore, që kjo marrëdhënie të ishte më bashkëpunuese, më transparente për të krijuar frymën e një ekipi të përbashkët për të ndryshuar tregun.

Më konkretisht: ndryshuam rregulloren “Për marrëdhëniet e punës së punonjësve në Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, duke rritur kompetencat e bordit për emërimet dhe shkarkimet e drejtorëve të drejtorive dhe departamenteve. Kjo ka nisur të zbatohet që vitin e kaluar, ku të gjithë drejtorët e drejtorive në proceset emëruese dhe shkarkuese kalojnë në bord.

Së dyti, miratuam shoqërinë audituese të Autoritetit në bord, si dhe drejtuesi i njësisë së auditimit u përzgjedh nga bordi pas intervistave të kryera po nga bordi.

Këto ndryshime pozitive kanë dhënë një impakt në opinionin e Bankës Botërore dhe FMN-së, duke vlerësuar jo vetëm bashkëpunimin, por edhe rritjen e kapaciteteve mbikëqyrëse të Autoritetit.

Për të gjithë punonjësit, të cilët u prekën nga konflikti midis ekzekutivit dhe bordit, kam kërkuar që të kthehen në autoritet, përveç këshilltares, ku ka pranuar vetëm zonja Rama, që është

drejtuesja e Departamentit të Tregut të Sigurimeve, dy të tjerët kanë preferuar të vazhdojnë në sektorin privat dhe të mos ktheheshin më në Autoritet.

**Pajtim Melani** - Pyetja 23: cila ka qenë veprimtaria e Komitetit të Kontrollit të AMF-së, si një organ qeverisës dhe forcues i kontrollit të AMF-së, në dritën e kërkesave që shtrën ligji për AMF-në dhe ligji për auditimin e brendshëm publik?

Për vitin 2017 Komiteti i Kontrollit të AMF-së ka funksionuar si organizëm *ad hoc* dhe është mbledhur vetëm në një rast, sipas urdhrit nr. 1, datë 03.02.2017 të kryetarit të bordit. Raporti i Komitetit të Kontrollit është protokolluar në datën 22.02.2017 dhe i referohet kryesisht tematikës, e cila u prek në atë kohë, rezolutës së Kuvendit për marrëdhëniet midis ekzekutivit dhe bordit për çështjen e kapaciteteve dhe burimeve njerëzore në AMF, si dhe për rregulloren “Për marrëdhëniet e punës së punonjësve në Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, e cila kishte kaluar një sagë të gjatë mosprotokollimi dhe moszbatimi.

Në parashkrim të ligjit drejtori i Përgjithshëm ekzekutiv është përgjegjës për zbatimin e të gjitha vendimeve të bordit. Për këtë arsye, nëpërmjet auditit të brendshëm, ne kemi marrë të gjitha masat dhe i kemi botuar në raportin vjetor për vitin 2017, si dhe në vijim për vitin 2018. Duhet thënë se vakanca e drejtuesit të njësisë së auditit, i cili varet drejtpërdrejtë nga bordi, është lançuar disa herë në web në raportin e vitit 2017, por është bërë e mundur që të zgjidhet vetëm në fillim të këtij viti. Tashmë me auditin e IT-së dhe me auditin financiar i është kërkuar që të sjellë në këtë mbledhje të bordit të gjithë planin e auditimit financiar dhe performancës, aq sa i takon zbatimit të vendimeve të bordit nga ekzekutivi i AMF-së. Në vijim, sipas rasteve, në qoftë se paraqiten problematika Komiteti i Kontrollit mund të propozohet nga secili prej nesh, 3 anëtarët joekzekutivë të bordit, për të shqyrtuar një çështje të caktuar dhe për të marrë masat përkatëse.

Faleminderit!

**Ervin Koçi** – Këtu përfundua përgjigjet për pyetjet tuaja, zoti kryetar!

Vazhdojmë me pyetjet e deputetes Antoneta Dhima.

1. Në mbyllje të pasqyrave financiare të vitit 2017, a rezulton ndonjë tepricë e papërdorur nga ana juaj deri më 31.12.2017? Sa është kjo tepricë? Çfarë keni menduar të bëni me këtë tepricë dhe cili është destinacioni i përdorimit të kësaj teprice?

Në mbyllje të pasqyrave financiare të vitit 2017 rezulton se teprica e papërdorur nga ana jonë është në shumën 59 milionë lekë të rinj. Në zbatim të ligjit teprica i kthehet e gjitha tregut, sipas përqindjes që shoqëritë kanë kontribuar në Autoritet.



Faktikisht destinacionin e zgjedhin vetë shoqëritë, por e mira do të ishte që kjo tepricë të kishte një llogari të qëllimshme. Pra, ne mendojmë që këto lekë të shkojnë për kompensime, ose për zhvilluar një sistem IT-je në byro, apo për zhvillime të tjera, në mënyrë që shkojnë në funksion të tregut. Kur kjo tepricë u kthehet shoqërive, përgjithësisht ato nuk kanë asnjë ndikim, përveçse rrinë në asetet e shoqërive.

2. Në raportin e paraqitur nga ana juaj citohet se AMF-ja ka ndryshuar strukturën gjatë vitit 2017. A ka ndryshuar numri total i punonjësve? A i përgjigjen numri aktual i punonjësve dhe aftësitë e tyre tregut, që ju aktualisht mbikëqyrni?

Ne kemi ndryshuar strukturën, por jo numrin total të punonjësve. Ne kemi bërë vetëm disa ndryshime për sa i përket dedikimit të tregjeve të specifikuara dhe përgjegjësitë që ka çdo punonjës. Njëkohësisht, kemi hequr shefat e sektorëve, sepse me strukturën e vjetër kishte më shumë përgjegjës dhe shefa se sa punonjës. Ne i kthym shefat në specialistë, të cilët e kanë bërë strukturën më dinamike, por edhe më produktive.

Numri aktual i punonjësve nuk u përgjigjet nevoja, por, megjithatë, tregjet janë dinamike, pa diskutim, duke parë edhe vendet e rajonit që janë më të zhvilluara. Në të ardhmen mund të kërkojmë shtesë të punonjësve, por aktualisht me numrin që kemi caktuar me vendimin e bordit besoj se u përgjigjet sfidave që do të përballemi këtë vit.

Ne jemi përpjekur që të rrisim shumë edhe aftësitë profesionale të punonjësve me trajnime, sidomos me projektin SECO do të kemi trajnime falas, ku do të trajnohen 15 punonjës në tregun e kapitaleve. Mendoj se ata do të trajnohen nga universitetet më të mira në botë, qoftë edhe për të marrë CISI-në, që është një standard botëror në tregun e kapitaleve.

3. Në vijim të pyetjes së dytë që lidhet me strukturën, do doja të dija nga ana juaj se çfarë po bën AMF-ja sa i takon rritjes së kapaciteteve të burimeve njerëzore në funksion të zhvillimeve të reja të tregut të letrave me vlerë?

Forcimi i kapaciteteve institucionale ka qenë dhe mbetet një ndër objektivat kryesorë të punës AMF-së, me qëllim zhvillimin e qëndrueshëm të tregut, por edhe për të krijuar një administratë më të qëndrueshme. Njëkohësisht, siç e thashë, ne jemi bazuar shumë në projektin SECO për sa i përket forcimit të kapaciteteve të AMF-së në mbikëqyrjen e tregut. Njëkohësisht, për të përgatitur edhe dinamikën dhe zhvillimin e tregjeve në vitet në zhvillim, unë besoj se do të ketë një ndryshim më pozitiv se sa kanë qenë zhvillimet deri tani. Gjithsesi, është një problem

real, që cilësia e punonjësve duhet të jetë më e shpejtë se sa zhvillimi i tregjeve dhe ne realisht jemi duke u angazhuar për ta ndryshuar këtë gjë pozitivisht.

Zoti Bushaj ka bërë tri pyetje:

Së pari: a është i mbuluar gjithë tregu i sigurimeve në Republikën e Shqipërisë?

Faktikisht e kam përmendur në fjalën time në seancën e parë në këtë komision: pa diskutim që gjeografia nga operatorët mbulohet, por nuk mbulohet në produkte. Deri tani 65% e produkteve vijnë nga sigurimi i detyrueshëm, pra nga mjetet motorike, kurse pjesa tjetër vijnë nga sektori bankar që, pothuajse, është i detyrueshëm, sepse në qoftë se merr një kredi, do të paguash sigurimin e jetës dhe sigurimin e pronës, një pjesë nga ndërmarrjet publike. Pra është e mbuluar nga kompanitë, por jo në të gjitha llojet e produkteve dhe produktet nuk janë shumë atraktive për qytetarët, njëkohësisht nuk ka një angazhim konkret nga Këshilli i Studimeve për të zhvilluar këtë produkt. Edhe ligji i ri që kemi sjelle për sigurimin e detyrueshëm, është bazuar në ndryshimin e konceptit të shoqërive, të cilat duhet të fokusohen më shumë në produktet vullnetare, duke ofruar më shumë shërbime për qytetarët.

A mund të ndihmojë Autoriteti për sigurimin e serave dhe prodhimeve bujqësore?

Në Shqipëri ekziston produkti i Sigurimit të Bujqësisë dhe Blegtorisë, me anë të të cilit bëhet e mundur sigurimi i ndërtesave, makinerive bujqësore, investimeve në bujqësi, prodhimi bujqësor, kafshët bujqësore dhe kafshët me vlera të veçanta përdorimi etj. Krijimi i këtij produkti ka si qëllim të përgjithshëm përmirësimin e kushteve të jetës së popullsisë, që merret me këto aktivitete nëpërmjet stabilizimit të të ardhurave familjare, që vijnë nga veprimtaria. Bashkë me Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural si dhe Qeverinë e Republikës së Italisë, e përfaqësuar nga Ministria e Punëve të Jashtme, Drejtoria e Përgjithshme e Bashkëpunimit për Zhvillim janë angazhuar në krijimin e një “projekti pilot “Për krijimin dhe eksperimentimin e një sistemi sigurimesh të lehtësuara për mbulimin e rreziqeve në bujqësi”. Objektivi specifik i Programit synon krijimin dhe eksperimentimin në nivel kombëtar të një sistemi sigurimesh të lehtësuara kundër rreziqeve të fatkeqësive natyrore për sektorin e bujqësisë. Njëkohësisht, në gjysmën e dytë të vitit 2017 kemi fituar një projekt, duke u renditur një nga 4 fituesit në botë për Projektin e Mikrosigurimeve “Akses në Iniciativën e Sigurimeve” dhe për të zhvilluar produkte të sigurimeve në sektorin bujqësor të biznesi i vogël. Në muajin nëntor ne do të dalim me produkte konkrete për t’ua ofruar shoqërive dhe besoj se, nëse do të ketë ndryshime ligjore apo dhe nevojë për bashkëpunim, do të vlerësohej shumë ndihma nga Kuvendi.

Polica e sigurimit me numër serial unik a ka elemente të tjera sigurie? A janë të gjitha shoqëritë e sigurimit me numër seria apo është unik për të gjitha shoqëritë e sigurimit që operojnë në Republikën e Shqipërisë?

Ju thashë se, që nga muaji janar i vitit 2018 ne kemi vendosur numrin unik për çdo policë sigurimi dhe çdo shoqëri, që i merr nga byroja të ndara, ku secila ka listën e vet të numrit të policave, me qëllim që, kur të shkojmë të kemi mundësinë t'i inventarizojmë, qoftë ne apo dhe administrata tatimore. Përveç numrit serial, i cili është një kod unik me 9 shifra, polica e sigurimit ka edhe elemente të tjera sigurie, si: vula metalike e gdhendur dhe shkrimet me dritëhije nëpër policë. Kodi dhe polica kanë numër tjetër unik nga Autoriteti, i cili del nga direkt nga sistemi i IT-së. Ne kemi bërë të mundur që fleta e policës të jetë e një lloji të veçantë, me ngjyrë të veçantë dhe të ndryshojë vit pas viti, në mënyrë që të ato të mos kenë mundësi të përdoren në vitet në vijim.

Gjithsesi, e rëndësishme është që në të ardhmen të ecim drejt (*nuk kuptohet*) të policës, siç ecin të gjitha vendet e BE-së, e cila heq përfundimisht ato shitjet problematike, të cilat u theksuan edhe këtu në komision për jashtë sistemit dhe për të vendosur një standard të ri, që të jetë më e thjeshtë për konsumatorët.

Pyetja tjetër është e zotit Pëllumbi. Çfarë risish sjell projektligji për sigurimin e detyrueshëm të mjeteve motorike dhe sa favorizohen konsumatorët prej tij?

Është një projektligj që ne e kemi sjellë dhe ia kemi dorëzuar edhe Ministrisë së Financave. Unë e vlerësoj miratimin e projektligjit për të kaluar në një stad të ri në tregun e sigurimeve dhe për të ndryshuar tërësisht filozofinë e tregut të sigurimeve, që të kalojë nga sigurime të detyrueshme në ofrimin e produkteve të sigurimeve vullnetare siç e kanë të gjitha vendet e rajonit dhe të botës.

Risitë janë:

Harmonizon më tej legjislacionin me direktivat europiane të fushës së sigurimit motorik, të cilat kanë për qëllim harmonizimin e funksionimit dhe mbikëqyrjes së kësaj veprimtarie;

synon të rrisë efikasitetin e marrëdhënieve ndërmjet aktorëve në tregun e sigurimit të detyrueshëm të përgjegjësisë civile nga përdorimi i automjeteve në funksion të rritjes së cilësisë së shërbimit ndaj konsumatorit, si dhe përmirësimin e problematikave të ligjit aktual të sigurimit të detyrueshëm nga ana e autoriteteve përgjegjëse;

do të ndikojë në uljen e numrit të drejtuesve të mjeteve të transportit që qarkullojnë të papajisur me kontratën e sigurimit të detyrueshëm nëpërmjet shtimit dhe forcimit të masave administrative deri në ndalimin administrativ të mjetit ndaj pronarit të mjetit, i cili nuk ka lidhur kontratë të sigurimit të detyrueshëm;

në kuadër të frymës së liberalizimit të tarifimit të primeve, tarifat e primit të sigurimit të detyrueshëm do të përcaktohen nga vetë shoqëritë e sigurimit dhe nuk mund të ndryshohen me shumë se dy herë brenda vitit kalendarik. Shpenzimet e marrjes në sigurim, shpenzimet administrative, si dhe pjesa e llogaritur për fitimin e shoqërisë së sigurimit, që sot kapin 70% të vlerës, ne kemi bërë që të mos jenë më shumë se 40% të primit të shkruar bruto, dhe nga këto vetëm 12% të jenë komision ndërmjetësimi, pasi sot janë mbi 30%. Pra, është bërë në këtë mënyrë, me qëllim që, paratë që Kontrata e Sigurimit mbledh nga primet bruto nga qytetarët, t'u rikthehen përsëri qytetarëve nëpërmjet pagesave që ndikojnë në uljen e çmimit të policës së sigurimit.

Gjithashtu, është edhe implementimi i sistemit Bonul Malus, që faktikisht jemi të vonuar në implementimin e tij, por tani kemi të gjithë infrastrukturën e nevojshme, duke bërë të mundur që çdo drejtues mjeti të ketë policën e sigurimit bazuar te historiku i tij, si drejtues mjeti. Ai qytetar që ka bërë më shumë aksidente, do të ketë një policë më të shtrenjtë dhe ai që nuk ka bërë aksidente do të ketë ulje të çmimit të policës së sigurimit.

Njëkohësisht, kemi përmirësuar ndjeshëm, në funksion të mbrojtjes së konsumatorit, procedurat dhe afatet për trajtimin e kërkesave për dëmshpërblim nga ana e shoqërive të sigurimit në mënyrë që të shmangen problematikat dhe rastet abuzive që janë hasur deri më sot në trajtimin e kërkesave për dëmshpërblim, si dhe procesi i dëmshpërblimit të jetë sa më transparent për përfituesin. Është parashikuar se shoqëria e sigurimit duhet të kryejë pagesën e dëmshpërblimit në llogarinë bankare personale të të dëmtuarit ose përfituesit, sepse më parë ka shkuar në llogari të tjera dhe kanë lindur probleme, pasi qytetarët nuk kanë marrë lekët, duke krijuar kështu probleme në të ardhmen.

Për kërkesat me vlerë të vogël, për dëme ndaj pronës deri në 100 mijë lekë të reja, afati i dëmshpërblimit është parashikuar të jetë 14 ditë nga data e marrjes së kërkesës për dëmshpërblim. Kemi zgjeruar fushën e mbulimit të kontratës së sigurimit të përgjegjësisë për dëmet ndaj personit dhe ndaj pronës që mund t'u shkaktohen palëve të treta nga përdorimi i mjetit motorik, duke ju referuar edhe direktivës europiane për sigurimin motorik, ku përfshihen

edhe dëmet që mund t'u shkaktohen këmbësorëve, çiklistëve, si dhe përdoruesve të mjeteve jo-motorike që lëvizin në rrugë.

Kemi rritur kufirin minimal të përgjegjësisë që mbulohet nga Kontrata e Sigurimit të Detyrueshëm. Nëse kufiri minimal i përgjegjësisë është rritur me rreth 2,7 herë, se ne po shkojmë drejt Europës dhe duhet ta kemi kufirin minimal 5 milionë euro, tashmë këtë vit kemi parashikuar të jetë 1 milion euro, 135 milionë lekë të reja në ligjin aktual që kemi propozuar.

Njëkohësisht, në përputhje me direktivën europiane “Për sigurimin motorik” duke u bazuar në disa legjislacione si, ai i Sllovenisë, Serbisë, Kroacisë edhe në funksion të edukimit të drejtuesve të mjeteve motorike, që të mos përdorin alkoolin gjatë drejtimit të mjetit, të përdorin rripin e sigurimit, si një mjet që siguron jetën, të mos shkelin rregullat, duke tejkaluar normat e shpejtësisë, etj, ne kemi marrë disa masa në mënyrë që këto të ndikojnë në edukimin e qytetarit, që ai të bëhet i përgjegjshëm për respektimin e rregullave të qarkullimit rrugor për rastet kur nuk i zbaton.

Besoj se me këtë zgjidhet përfundimisht problemi i byrosë, duke e ndarë në dy ente trupën menaxhuese të saj, e cila nuk do të jenë më me drejtorët e përgjithshëm të shoqërive, por do të jetë një trupë tjetër drejtuese, që nuk do të varet prej tyre dhe do të revokojë licencën e një operatori, pra të një kompanie, e cila nuk zbaton detyrimet dhe vendimet që merren nga autoriteti.

Pak a shumë këto janë ndryshimet kryesore. Gjithsesi projektligji ka pasur përherë qëllim mbrojtjen e konsumatorit. Edhe pse në disa media ka dalë që nuk janë bërë konsulta, dua të them që ne i kemi bërë ato me të gjitha grupet e interesit, por kjo nuk do të thotë të marrësh të gjitha mendimet e grupeve të interesit, sepse ne kemi marrë ato që i kemi konsideruar si të vlefshme për mbrojtjen e konsumatorit.

**Erion Braçe** – Nuk ka më pyetje të tjera? Dakord.

Do t'ju kërkoja që të gjitha përgjigjet e bëra me shkrim t'i depozitoni pranë sekretarisë së Kuvendit, me qëllim që secili nga deputetët t'i ketë në dispozicion për të organizuar javën e ardhshme një seancë diskutimi lidhur me raportimin dhe me sqarimet e bëra në këtë komision në referencë të pyetjeve të bëra nga kolegët.

Mbledhja e sotme mbyllet këtu dhe shpresojmë që javën e ardhshme të jemi në normalitet, meqë mitingu është ditën e shtunë, që të zhvillojmë një mbledhje krejt normale debati apo diskutimi, edhe me prezencën e tyre, po të duan!

Faleminderit!

**MBYLLET MBLEDHJA**